

World Vision



Vlerësimi i peizazhit dhe burimeve natyrore dhe zhvillimi i kurrikulave për adresimin e nevojave të fermerëve për rritje kapacitetesh

Bashkia Kurbin

Përgatitur nga Instituti i Studimeve Ekonomike dhe Transferimit të Njohurive
(ISETNJ)

Për World Vision Shqipëri

© Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet në asnjë formë, përveçse me leje nga publikuesi.

Raporti u hartua nga:

Dr. Drini Imami

Dr. Edvin Zhllima

Prof. Engjell Skreli

Puna në terren u realizua me mbështetjen e stafit të zyrave lokale të World Vision Shqipëri në Kurbin.

Mbështetur nga:

World Vision Hong Kong

Korrik 2020

Tabela e përmbajtjes

1. Hyrje.....	6
2. Metodologjia.....	8
2.1 Mbledhja e të dhënave dytësore.....	8
2.2 Mbledhja e të dhënave parësore.....	8
2.2.1 Vrojtimi i strukturuar	8
2.2.2 Mbledhja e të dhënave nga përfaqësues të qeverisë qendrore.....	10
2.3 Përpunimi dhe analiza e të dhënave.....	11
2.3.1 Të dhënat sasiore.....	11
2.3.2 Të dhënat cilësore	12
3. Burimet, përdorimi i burimeve dhe potencialet e zhvillimit – të dhëna dytësore	13
3.1. Të dhëna të përgjithshme për bashkinë Kurbin.....	13
3.2. Vizioni dhe objektivat strategjike	15
3.3. Përdorimi i burimeve të bashkisë.....	16
4. Burimet, përdorimi i burimeve dhe potencialet e zhvillimit – të dhëna parësore.....	19
4.1 Burimet e bashkisë.....	19
4.1.1 Burimet njerëzore në bashkinë Kurbin.....	19
4.1.2 Burimet natyrore prodhuese në bashkinë Kurbin.....	21
5. Shfrytëzimi i burimeve të bashkisë.....	24
5.1. Prodhimi në fermë.....	24
5.2. Prodhimi i produkteve të përpunuara në fermë.....	26
5.3. Aktivitetet blegtorale të fermës.....	26
5.4. Aksesimi në treg.....	28
5.5. Të ardhura të krijuara dhe burimet e të ardhurave	30
6. Potencialet e zhvillimit.....	33
7. Kapacitetet njerëzore dhe nevoja për rritjen e tyre	34
7.1 Vlerësimi i nevojave për rritje kapacitetesh dhe metoda e preferuar.....	34
7.1. Vlerësimi i nevojave prioritare për rritje kapacitetesh.....	34
7.2. Metoda e preferuar e rritjes së kapaciteteve.....	35
8. Ofruesi i këshillimit dhe informacionit, cilësia dhe qasja e shërbimit	37
8.1. Vlerësimi mbi ofruesin e këshillimit dhe informacionit, cilësinë dhe lehtësinë e qasjes... 37	
8.2. Situata dhe mënyra e komunikimit	38
9. Partnerët e zhvillimit për ofrimin e shërbimeve të këshillimit dhe informacionit	41
9.1. Partnerët e zhvillimit.....	41
9.2. Kapaciteti i partnerëve	41
10. Efektet e pandemisë Covid-19 mbi funksionimin e zinxhirëve të vlerës dhe sigurinë ushqimore	42
10.1. Efektet e pandemisë Covid-19 mbi funksionimin e zinxhirëve të vlerës.....	42
10.2. Efekti i pandemisë tek të ardhurat mujore familjare	42
10.3. Efektet e pandemisë Covid-19 mbi sigurinë ushqimore të familjeve	44
11. Konkluzione dhe rekomandime	50
12. Referencat.....	54
Aneksat.....	55

Lista e tabelave

Tabela 1: Përmbledhja e pyetjeve kërkimore, metodave dhe outputeve/rezultateve	9
Tabela 2: Familjet e intervistuar dhe popullsia korresponduese	10
Tabela 3. Prevalenca e Pasigurisë (qasjes) Ushqimore në Familje (HFIAP).....	12
Tabela 4. Të dhëna kryesore për Bashkinë Kurbin	13
Tabela 5: Njesitë e Bashkisë Kurbin.....	13
Tabela 6: Pesë sistemet e territorit në Kurbin	14
Tabela 7. Tregues të kapaciteteve prodhuese të zonës.....	15
Tabela 8. Projektet për prodhimin bujqësor.....	16
Tabela 9. Prodhimi bimor dhe shtazor	16
Tabela 10. Analiza SWOT - Sistemi bujqësor	17
Tabela 11: Familjet e intervistuar, popullsia koresponduese dhe përmasa e familjes.....	19
Tabela 12: Moshë mesatare sipas njësive administrative	19
Tabela 13: Struktura moshore e popullsisë së intervistuar në Kurbin, zonën e projektit dhe vendin	20
Tabela 14: Raporti i varësisë në bashkinë Kurbin, zonën e projektit dhe vendin	20
Tabela 15: Struktura gjinore e popullsisë së intervistuar	20
Tabela 16: Të dhëna mbi tokën në pronësi	21
Tabela 17: Të dhëna mbi tokën e përdorur	22
Tabela 18: Të dhëna mbi tregun e qerasë në Kurbin dhe zonën e projektit.....	22
Tabela 19: Mesatare e sipërfaqeve të tokës kultivuar me produktet specifike të zonës dhe pjesa e fermerëve që prodhojnë këto produkte sipas njësive administrative dhe në total - Kurbin	24
Tabela 20: Prodhimi drithërave, perimeve, vreshtave dhe ullinjve	25
Tabela 21: Rendimenti mesatar.....	25
Tabela 22: Shitja si përqindje ndaj prodhimit për produktet specifike të zonës dhe pjesa e fermerëve që i tregtojnë këto produkte sipas njësive administrative dhe në total për bashkinë Kurbin	25
Tabela 23: Prodhimi i produkteve të përpunuara në fermë, pjesa e fermerëve që prodhon dhe pjesa e shitur e prodhimeve sipas njësive administrative dhe në total	26
Tabela 24: Fermat që merren me aktivitete begtorale dhe nr. i krerëve për fermë sipas njësive administrative dhe në total për Bashkinë Kurbin.....	26
Tabela 25: Të ardhurat e familjeve në përqindje sipas burimit në Kurbin dhe sipas njësive administrative	30
Tabela 26: Shpenzimet, të ardhurat dhe kursimet familjare mujore në lekë në Kurbin.....	31
Tabela 27: Aktiviteti kryesor për antarët e familjes në moshë pune	31
Tabela 28: Emigrimi në Kurbin dhe zonën e projektit.....	32
Tabela 29: Perceptimet e fermerëve mbi produktin më të rëndësishëm potencial.....	33
Tabela 30. Metoda e preferuar e rritjes së kapaciteteve.....	35
Tabela 31: Ofruesi i këshillimit dhe informacionit	37
Tabela 32: Cilësia e këshillimit.....	38
Tabela 33: Qasja në këshillim dhe informacion.....	38
Tabela 34: Mjedisi ku komunikohet për teknologjinë e prodhimit.....	39
Tabela 35: Ndikimi i pandemisë në intensitetin e komunikimit	39
Tabela 36: Interneti si mënyrë komunikimi për informacion mbi teknologjinë e tregjet.....	40
Tabela 37: Partnerët e zhvillimit në Kurbin dhe zonën e projektit	41
Tabela 38: Perceptimi mbi kapacitetet e partnerëve për ofrimin e këshillimit dhe informacionit	41
Tabela 39: Ndryshimi i të ardhurave sipas kategorive për shkak të pandemisë për familjet në Kurbin	42
Tabela 40: Përgjigjet e pyetjes “Sa përqind të këtyre produkteve arrini ti prodhoni në fermën tuaj”	47
Tabela 41: Niveli i Pasigurisë (qasjes) Ushqimore në Familje	49
Tabela 42: Struktura moshore e popullsisë në Kurbin	55
Tabela 43: Perceptimet e fermerëve mbi aktivitetin e dytë dhe të tretë potencial	55
Tabela 44: Sipërfaqja e bimëve të arave sipas bashkive 2019	56

Tabela 45: Prodhimi i bimëve të arave sipas bashkive 2019	56
Tabela 46: Prodhimi i perimeve sipas bashkive 2019.....	56
Tabela 47: Gjendja numerike e drufrutorëve, 2019	57
Tabela 48: Prodhimi i drufrutorëve, 2019 në Ton.....	57
Tabela 49: Numri i krerëve të blegtorisë sipas bashkive, 2019	57
Tabela 50: Prodhimi i qumështit, 2019 (Ton).....	57
Tabela 51. Prodhimi i mishit - peshë e gjallë, 2019 (ton).....	57

Lista e figurave

Figura 1: Struktura arsimore e popullsisë së intervistuar	21
Figura 2: Perceptimet e fermerëve mbi burimet natyrore në bashkinë Kurbin.....	23
Figura 3: Ecuria e numrit të krerëve për fermat gjatë 5 viteve të fundit – Kurbin.....	27
Figura 4: Ecuria e numrit të krerëve për fermat gjatë 5 viteve të fundit – Njësia administrative Laç	27
Figura 5: Ecuria e numrit të krerëve për fermat gjatë 5 viteve të fundit – Njësia administrative Mamurras	28
Figura 6: Ecuria e numrit të krerëve për fermat gjatë 5 viteve të fundit – Njësia administrative Milot	28
Figura 7: Ecuria në vlerën e shitjeve të produkteve krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019 – Total Kurbin	29
Figura 8: Ecuria në vlerën e shitjeve të produkteve krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019 - Laç	29
Figura 9: Ecuria në vlerën e shitjeve të produkteve krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019 – Mamurras	30
Figura 10: Ecuria në vlerën e shitjeve të produkteve krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019 - Milot	30
Figura 11: Nevoja prioritare për rritjen e kapaciteteve për produktin prioritar	34
Figura 12: Përgjigjet e pyetjes “A kanë pësuar këto të ardhura ulje për shkak të pandemisë?” - Kurbin..	43
Figura 13: Përgjigjet e pyetjes “A kanë pësuar këto të ardhura ulje për shkak të pandemisë?” – Laç	43
Figura 14: Përgjigjet e pyetjes “A kanë pësuar këto të ardhura ulje për shkak të pandemisë?” – Mamurras	44
Figura 15: Përgjigjet e pyetjes “A kanë pësuar këto të ardhura ulje për shkak të pandemisë?” - Milot....	44
Figura 16: Shkalla e vështirësisë për konsumin e ushqimeve të mëposhtme përgjatë muajit mars-prill – Kurbin	45
Figura 17: Shkalla e vështirësisë për konsumin e ushqimeve të mëposhtme përgjatë muajit mars-prill – Laç	45
Figura 18: Shkalla e vështirësisë për konsumin e ushqimeve të mëposhtme përgjatë muajit mars-prill – Mamurras	46
Figura 19: Shkalla e vështirësisë për konsumin e ushqimeve të mëposhtme përgjatë muajit mars-prill – Milot.....	46
Figura 20: Rezultatet e pyetjes “Sa i/e shqetësuar jeni nëse do të jeni në gjendje apo jo të siguroni për veten dhe familjen tuaj ushqim dhe artikujt bazë gjatë 2 muajve të ardhshëm?”.....	47
Figura 21: Përgjigjet e pyetjeve për të vlerësuar pasigurinë e familjes për të aksesuar produkte ushqimore	48
Figura 22: Shqetësimet ndaj sigurimit të ushqimit të nevojshëm për familjen ndodhi prej pandemisë - Kurbin	48
Figura 23: Niveli i sigurisë ushqimore për familjet në bashkinë Kurbin dhe sipas njësive administrative	49
Figura 24: Nevoja e pare prioritare për rritje kapacitetesh per produktin e dyte prioritar	56

1. Hyrje

Varfëria ka qenë dhe vazhdon të jetë një shqetësim madhor i World Vision Shqipëri & Kosovë (WVAK). Qëllimi i strategjik i organizatës është që të kontribuojë në mirëqenien e fëmijëve. Në Shqipëri, WVAK punon me fëmijë, familjet e tyre dhe komunitetet në nëntë Zona Programi (ZP), që ndodhen në Durrës, Lezhë, Kurbin, Librazhd, Shkodër, Dibër, Korçë, Tiranë dhe Elbasan. Qasja kryesore e WVAK është fuqizimi i komuniteteve në mënyrë që atyre t'u mundësohet pjesëmarrja në procese zhvillimore. Puna e WVAK konsiston në aftësimin e fermerëve që të shprehin vetë nevojat e tyre për të qenë sa më efikas, të ekspozohen ndaj mësimëve sipas parimit të Empowered World View (EWV), të zhvillojnë njohuri bazë për tregjet dhe menaxhimin financiar, si edhe për shërbimet apo produktet që ofrohen nga institucionet mikrofinanciare, që të jenë në gjendje që të përdorin punën dhe mjetet e tyre për zhvillimin e bujqësisë dhe menaxhimin e burimeve natyrore në mënyrë të qëndrueshme.

Programi i Zhvillimit Ekonomik të WVAK synon të arrijë fuqizim të qëndrueshëm ekonomik të familjeve dhe komuniteteve në ZP si Dibra, Korça, Kurbin dhe Librazhd, duke ngritur kapacitetet e tyre për t'u përballur me sfidat dhe për të përmirësuar mirëqenien e fëmijëve. Duke marrë parasysh këtë qëllim, kohët e fundit Programi i Zhvillimit Ekonomik të WVAK kërkoi një vlerësim për identifikimin e gamës së ndërhyrjeve specifike të kërkuara për zbatimin e programeve të zhvillimit të kapaciteteve të integruara në fshatrat e përfshira nga Programi i Zhvillimit Ekonomik bazuar në një analizë të burimeve dhe nevojave të komuniteteve të fermerëve në fshatra të veçantë në zonat e programit në Dibër, Korçë, Kurbin dhe Librazhd.

Raporti i vlerësimit synon që të ofrojë rekomandime për zhvillimin e kapaciteteve kryesore që mundësojnë familjet e varfra rurale të synuara apo të mbështetura nga WVAK të shfrytëzojnë potencialet dhe burimet lokale të disponueshme. Qëllimi qëndron në mobilizimin e komuniteteve për të punuar së bashku për të marrë kontrollin e zhvillimit dhe për të ruajtur mjedisin e tyre, duke u siguruar kështu komuniteteve rurale një potencial më të madh për të hartuar dhe menaxhuar nismat e tyre të zhvillimit. Kështu që, pjesë e këtij studimi është identifikimi i programeve trajnuese për rritjen e kapaciteteve të popullsisë së varfër në zonat rurale të përzgjedhura si edhe informacione përkatëse në lidhje me ofruesit e shërbimeve dhe format më të përshtatshme për ofrimin e shërbimeve dhe këshillimit.

Qëllimi i këtij studimi është vlerësimi i potencialit me fokus:

- Identifikimi i burimeve natyrore dhe të bujqësisë (duke përfshirë prodhimin bujqësor, ujin, tokën, pyllin / pemët dhe tokat / kullotat) që mund të menaxhohen dhe zhvillohen për të kontribuar në fuqizimin ekonomik të familjeve në ZP Dibër, Maliq, Kurbin dhe Librazhd.
- Identifikimi i partnerëve të mundshëm që kanë një rol në përmirësimin e mundësive të familjeve për aktivitete që sjellin të ardhura, në secilën ZP.
- Vlerësimi i nevojave për ndërtimin e kapaciteteve të familjeve të varfëra për menaxhimin e bujqësisë dhe burimeve natyrore në zonat rurale.
- Ofrimi i ekspertizës dhe ndërtimi i kurrikulave në përputhje me nevojat e fermerëve për të mundësuar përdorimin e potencialeve lokale në secilën nga fushat e programit dhe për të përmirësuar përfshirjen e familjeve në aktivitete nga të cilat mund të gjenerohen të ardhura.

Instituti i Studimeve Ekonomike dhe Transferimit të Njohurive (ISETNJ) është përzgjedhur nga WVAK për të kryer këtë studim, për shkak të përvojës dhe ekspertizës unike që ka kjo organizatë. Ky raport, është pjesë e një serie raportesh që kanë strukturë të njëjtë (një për secilën ZP: Dibër, Kurbin, Librazhd dhe Maliq). Raporti është i strukturuar në 7 kapituj, ku hyrja dhe metodologjia përsëriten në çdo raport. Kapitulli 3 paraqet bazuar në të dhënat dytësore disa tipare të kushteve zhvillimore të zonës. Kapitulli 4 rendit burimet kryesore sipas opinionëve të të anketuarve dhe drejtuesve të komunitetit përkatës. Kapitulli 5 vijon me përshkrimin e mënyrave të shfrytëzimit të këtyre burimeve duke treguar prodhimin bimor dhe shtazor në zonë dhe përshkruar rentat e derivuara nga këto aktivitete. Kapitulli 6 tregon potencialet e zhvillimit të zonës bazuar në qëndrimet e fermerëve. Kapitulli 7 tregon nevojat për kapacitete njerëzore dhe preferencat e përfituesve të mbështetjes së WVAK për rritjen e këtyre kapaciteteve. Kapitulli i mëtejshëm tregon vlerësimin e të intervistuarve për cilësinë e shërbimeve të ofruar nga aktorë të ndryshëm. Kapitulli 9 tregon aktorët kryesorë të preferuar nga të anketuarit për të ofruar shërbime për ngritje kapacitetesh. Kapitulli 10

tregon efektet kryesore të pandemisë dhe kapitulli 11 përmyll raportin me konkluzionet dhe rekomandime.

Studimi bazohet kryesisht në një vrojtim me zgjedhje të kryer ndaj përfituesve të mbështetjes së WVAK. Në kohën e kryerjes së vrojtimit pandemia ishte në fazën kulmore. Për shkak të rrezikshmërisë që paraqiste kontakti i drejtpërdrejtë WVAK zbatoi anketimin nëpërmjet komunikimit në distancë (telefon dhe hedhja e të dhënave në kompjuter). Kjo qasje sjell kufuzime në të kuptuarin e pyetjeve, në plotësimin e përgjigjeve dhe në saktësinë e përgjigjeve. Pyetje opsionale në lidhje me efektin e pandemisë patën një numër të ulët përgjigjesh. Ky kufizim u adresua nga ekspertët pas vrojtimit duke rritur numrin e intervistave për të saktësuar të dhënat.

2. Metodologjia

2.1 Mbledhja e të dhënave dytësore

Burime të ndryshme janë përdorur për të mbledhur të dhëna dytësore, përfshirë Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë, qeverisjen lokale (planet lokale të zhvillimit ose strategjitë e zhvillimit rajonal të bashkive), Instituti i Statistikave në Shqipëri (INSTAT), studimet e kryera nga agjenci të ndryshme zhvillimi etj. Gjatë periudhës së studimit, ekipi i ISETNJ ka bashkëpunuar ngushtë me ekipin e WVAK në lidhje me identifikimin e burimeve të rëndësishme të të dhënave sekondare – autorët e studimit gjejnë rastin të vlerësojnë mbështetjen e pakufizuar nga WVAK.

2.2 Mbledhja e të dhënave parësore

Katër instrumente kryesore janë përdorur për përfitim të të dhënave parësore, përkatësisht vrojtimi i strukturuar i fermerëve, intervistat gjysmë të strukturuar të thelluara dhe takimet e validimit.

2.2.1 Vrojtimi i strukturuar

Vrojtimi i strukturuar targetoi ferma familjare si njësi të analizës në secilën ZP (pra përkatësisht në Dibër, Librazhd, Kurbin dhe Maliq) – pyetësi mundësonte mbledhjen e të dhënave socio-ekonomike (si moshë, arsimit, statusi i punësimit - në fermë dhe punësimi jashtë fermës, përfshirë emigrimin); të dhëna rreth aktiviteteve bujqësore dhe jo-bujqësore; burimeve të të ardhurave etj. Gjithashtu u mbledhën të dhëna rreth të ardhurave për potencialet e aktivitetit ekonomik bazuar në burimet natyrore; hapësirat për zhvillim; nevojat për ndërtimin e kapaciteteve që lidhen me aktivitetet kryesore bujqësore, duke përfshirë nevojat për teknologjinë, menaxhimin financiar, veprimin kolektiv (bashkëpunimi me njëri-tjetrin), marrëdhëniet me blerësin dhe aksesin në treg, si edhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Tabela 1: Përmbledhja e pyetjeve kërkimore, metodave dhe outputeve/rezultateve

Cështjet/temat	Metoda	Burimi	Outputi/Rezultati
Vlerësimi i burimeve natyrore (tokë bujqësore, kullota pyjore, ujë) në secilën ZP	Rishikim literature	Strategjitë e zhvillimit rajonal, planet lokale të zhvillimit, agjencitë rajonale të bujqësisë	Përshkrimi cilësor i burimeve natyrore për secilën zonë të programit duke përdorur tregues krahasues të disponueshëm
	Intervista gjysëm të strukturuar të thelluara *		
	Workshopet apo takimet validuese***		
Vlerësimi i potencialeve për aktivitetet ekonomike të fermave (bimët, bagëtitë, përpunimin në fermë, turizmin, etj.) (përfshirë produktet tipike) bazuar në burimet natyrore	Rishikim literature	Literatura	Një listë e aktiviteteve të mundshme që lidhen me burimet natyrore (kulturat bujqësore, blegtoria, përpunimi në fermë, turizmin, etj.) vlerësimi cilësor (me të dhëna cilësore) i potencialeve dhe renditja e mundshme
	Intervista gjysëm të strukturuar të thelluara (aktorë të mirëinformuar) *		
	Vrojtimi i strukturuar me fermerë**		
	Të dhëna të mbledhura nga zyrtarë të qeverisë vendore		
	Workshopet apo takimet validuese***		
Gjendja aktuale e shfrytëzimit të mundësive dhe burimeve si edhe hapësira për zhvillim	Rishikim literature	Të dhëna administrative (ARZH)	Vlerësimi i gjendjes aktuale dhe potencialeve përfshi hapësirën për zhvillim bazuar në kushtet e ofertës dhe kërkesës
	Intervista gjysëm të strukturuar të thelluara *		
	Vrojtimi i strukturuar me fermerë**		
	Të dhëna të mbledhura nga zyrtarë të qeverisë vendore		
	Workshopet apo takimet validuese***		
Vlerësimi i nevojave për ndërtimin e kapaciteteve në lidhje me aktivitetet e mundshme (kulturat bujqësore, blegtoria, përpunimi në fermë, turizmin, etj.)	Intervista gjysëm të strukturuar të thelluara (aktorë të mirëinformuar)*		Nevojat për ndërtimin e kapaciteteve në drejtim të teknologjisë, menaxhimit financiar, veprimet kolektiv, marrëdhëniet me blerësit, menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, etj.
	Vrojtim i strukturuar**		
	Të dhëna të mbledhura nga zyrtarë të qeverisë vendore		
	Workshopet apo takimet validuese***		
Identifikimi i partnerëve, dhe vlerësimi i interesave dhe kapaciteteve të tyre	Intervista gjysëm të strukturuar të thelluara (aktorë të mirëinformuar) *		Lista e partnerëve dhe interesi dhe kapacitetet relevante - Rekomandime për partnerët që kanë më shumë potencial
	Workshopet apo takimet validuese***		
Vlerësimi i ekspertizës që ofrohet në ZP	Intervista gjysëm të strukturuar të thelluara (aktorë të mirëinformuar) *		OJF, qeveria (struktura të qeverisë qendrore dhe lokale), konsulentët
	Workshopet apo takimet validuese***		

Burimi: Punim i autorëve

Hartimi dhe testimi i pyetësorit

Disa aspekte metodologjike u morën parasysh gjatë hartimit të pyetësorit, përfshirë madhësia e pyetësorit; formulimi i pyetjeve (pyetjet u formuluan të tilla që të ishin lehtësisht të kuptueshme nga të anketuarit); renditja e pyetjeve (pyetjet e ndjeshme dhe të vështira për t'u përgjigjur u vendosen në fund). Pyetësi u testua dhe u përmirësua përpara fillimit të mbledhjes së të dhënave. I gjithë ky proces u krye në bashkërendim të ngushtë me stafin e WVAK.

Përcaktimi i mostrës

Mostra, përfshirë këtu fshatrat si edhe familjet që u përfshinë në vrojtimit u zgjodh nga stafi i WVAK, në përputhje me zonat ku operojnë dhe familjet që mbështesin. Në këtë raport janë përgjigjur gjithsej 106 përfaqësues familjesh fermere, përkatësisht 7 në njësinë administrative Laç, 70 në njësinë administrative Mamurras dhe 29 në njësinë administrative Milot. Përderisa, përfaqësuesi i familjes u përgjigj për anëtarët e familjes, atëherë numri i individëve të përfshirë në analizë është pesë herë më i lartë (Tabela 2).

Tabela 2: Familjet e intervistuar dhe popullsia korresponduese

Treguesit	Njësia administrative			Kurbin Total	Zona e projektit
	Laç	Mamurras	Milot		
Numri i familjeve të intervistuar	7	70	29	106	439
Numri i popullsisë që i korrespondon familjeve të intervistuar ¹	36	360	135	531	2115

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

Zbatimi i vrojtimit

Ekipi i ISETNJ ndoqi një seri fazash për të mundësuar një zbatim të suksesshëm të këtij studimi, si dhe për të grumbulluar informacionin e saktë nga grupet e synuara. Për nevojat specifike të këtij vlerësimi, ekipi i ISETNJ ndoqi një qasje që përfshin dy faza të anketimit. Faza përgatitore konsistoi në këto hapa:

- hartimi dhe përfundimi i pyetësorit;
- përcaktimi i mostrës;
- në bashkëpunim të ngushtë me ISETNJ, WVAK programoi platformën e hedhjes së të dhënave (kjo u krye nga stafi i WVAK);
- pas programimit për përdorimin e tabletave/PC-ve, ISETNJ bëri seanca pilot të shkurtra, për të identifikuar probleme dhe kështu u krye përmirësimi i pyetësorit;
- më pas ISETNJ zhvilloi seanca trajnimi për stafin e WVAK për të kryer intervistat. Sesionet e trajnimit ofruan shpjegime për kontekstin dhe përmbajtjen e pyetjeve të pyetësorit;
- vrojtimi u implementua nga stafi i WVAK.

2.2.2 Mbledhja e të dhënave nga përfaqësues të qeverisë qendrore

Informacioni që u mbledh përmes këtij instrumenti përfshin: potencialet e veprimtarisë ekonomike të fermave (të korrave, bagëtime, aktivitetet e përpunimit në fermë, turizmit, etj.) (përfshirë produktet dhe shërbimet tipike) bazuar në burimet natyrore; gjendja aktuale e shfrytëzimit të mundshëm dhe hapësira për zhvillim; nevojat për ndërtimin e kapaciteteve në lidhje me aktivitetet e mundshme bujqësore, etj.

Për të përfutur më shumë informacion, sidomos të natyrës cilësore, që nuk mund të përftohej dot nga pyetësi/vrojtimi i strukturuar si edhe për të validuar dhe kuptuar më mirë gjetjet nga vrojtimi i strukturuar u realizuan intervista gjysëm të strukturuar në grup si edhe me individë. Për këtë qëllim në pyetësorët gjysëm të strukturuar u përfshi informacion për aspekte të ndryshme si psh. strategjitë e ardhshme të fermës dhe jetesës (sjellja e planifikuar), vlerësimi i burimeve natyrore (tokë bujqësore, kullota pyjore, ujë) financimi në secilën ZP; potencialet e aktivitetit ekonomik të familjes së fermave

¹ Diferenca mes numri i të aketuarve që i korrespondon familjeve të intervistuar dhe numrit të raportuar në tabela ose figura, përfaqëson të dhëna të munguara (missing cases).

(kulturë bujqësore, bagëti, përpunim në fermë, turizëm, etj.) (përfshirë produktet tipike) bazuar në burimet natyrore; identifikimi i partnerëve, interesave dhe kapaciteteve të tyre; ekspertizën e disponueshme; nevojat për ndërtimin e kapaciteteve që lidhen me aktivitetet e ndryshme bujqësore dhe blegtorale, duke marrë parasysh nevoja të ndryshme siç janë nevojat për sa i përket teknologjisë, menaxhimit financiar, veprimet kolektiv, marrëdhëniet me blerësit, menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, etj.

Intervistat gjysmë të strukturuar u kryen nga ekipi i ISETNJ, bazuar në pyetësorët e përgatitur paraprakisht. Pyetësorët gjysmë të strukturuar u përdorën si "udhëzues" dhe jo si "recetë", duke mundësuar lirshmërinë në komunikim dhe duke mundësuar hapësira për të diskutuar aspekte relevante që dëlnin gjatë intervistave. Gjatë kryerjes së intervistave, anëtarët e ekipit të ISETNJ mbajtën shënime dhe bënë përmbledhjen e gjetjeve të cilat u reflektuan në raport.

2.3 Përpunimi dhe analiza e të dhënave

2.3.1 Të dhënat sasiore

Ekipi i ISETNJ i analizoi të dhënat përmes programit SPSS, një program i specializuar për analizën statistikore për përpunimin e rezultateve dhe analizave statistikore. Në bazën e të dhënave të SPSS u specifikuan emërtesat dhe tipologjia e variablave.

Gjatë përpunimit dhe raportimit të të dhënave u përgatitën tabela të shumta që reflektonin të gjitha rezultatet kryesore (në formë frekuencash dhe tabelash të kryqëzuara). Pas analizës paraprake të rezultateve, u vazhdua me interpretimin dhe vizualizimin e të dhënave (në formë tabelash dhe grafikësh).

Dy tregues u përllogaritën duke përdorur të dhënat e studimit që janë Niveli i Pasigurisë (qasjes) Ushqimore në Familje (Household Food Insecurity Access-related Domains ose HFIAS²) dhe Prevalenca e Pasigurisë (qasjes) Ushqimore në Familje (HFIAP).

Niveli i Pasigurisë (qasjes) Ushqimore në Familje ofron informacion të përmbledhur mbi mundësinë që një familje të përjetojë një ose më shumë sjellje në secilën nga tre fushat e pasqyruara në HFIAS të cilat janë ankthi dhe pasiguria, cilësi e pamjaftueshme dhe sasi e pamjaftueshme ushqimore. Treguesi i HFIAS është një vlerë e vazhdueshme e shkallës së mos-sigurimit ushqimor (qasjes) në familje me vlera të cilat variojnë nga 0 në 15, ku sa më i lartë të jetë rezultati, aq më shumë pasiguri ushqimore (qasjes) e ka përjetuar një familje.

Një tregues tjetër është Prevalenca e Pasigurisë (qasjes) Ushqimore në Familje (HFIAP): Treguesi HFIAP i kategorizon familjet në katër nivele të pasigurisë (apo qasjes) ushqimore shtëpiake (**Error! Not a valid bookmark self-reference.**):

1. Familje me akses të sigurtë në ushqim,
2. Familje me nivel të moderuar të pasigurisë ushqimore. Një nivel i moderuar i pasigurisë ushqimore të familjes do të thotë se familja shqetësohet për mos pasje ushqimi të mjaftueshëm ndonjëherë ose shpesh, dhe / ose nuk është në gjendje të hajë ushqime të preferuara, dhe / ose ha një dietë më monotone sesa ajo e dëshiruar dhe / ose disa ushqime të konsideruara të padëshirueshme, por vetëm rrallë. Por kjo nuk tkurr sasinë dhe as nuk përjeton asnjë nga tre kushtet më të rënda (mbarimi i ushqimit, shkuarja në shtrat i uritur, ose shkuarja e tërë ditës dhe natës pa ngrënë).
3. Familje me nivel të konsiderueshëm të pasigurisë ushqimore. Një familje me nivel të konsiderueshëm të pasigurisë së ushqimit sakrifikon cilësinë më shpesh, duke ngrënë një dietë monotone ose ushqime të padëshirueshme ndonjëherë ose shpesh, dhe /ose ka filluar të shkurtojë sasinë duke zvogëluar





² Për më tepër konsultohuni tek lidhja http://www.fao.org/fileadmin/user_upload/eufao-fsi4dm/doc-training/hfias.pdf

madhësinë e vakteve ose numrin e vakteve, rrallë ose ndonjëherë. Por nuk pëson asnjë nga tre kushtet më të rënda. Një familje me pasiguri të lartë ushqimore është e prirur për të ulur shpesh sasinë e vaktit ose numrin e vakteve, dhe/ose përjeton ndonjë nga tre kushtet më të rënda (mbarimi i ushqimit, shkimi në shtrat i uritur, ose shkuarja e tërë ditës dhe natës pa ngrënë), edhe aq rrallë si rrallë.

4. Familje me nivel të lartë të pasigurisë ushqimore janë familje të cilat vuajnë shpesh ndodhinë e ngjarjeve si mbarimi i ushqimit, të shkuarit në shtrat i uritur, ose shkuarja e tërë ditës dhe natës pa ngrënë.

Tabela 3. Prevalenca e Pasigurisë (qasjes) Ushqimore në Familje (HFIAP)³

Pyetje	1-Rrallë (një apo dy herë)	2-Ndonjëherë (3 deri në 10 herë)	3-Shpesh (mëshumë se 10 herë)
U shqetësove se familja juaj nuk do të kishte ushqim të mjaftueshëm?			
Ju duhet të ushqeheshit me një larmi të kufizuar të ushqimeve?			
Ju është dashur të konsumoni disa ushqime që ju me të vërtetë nuk doni të hani?			
Ju ose ndonjë anëtar i familjes duhet të hani një vakt më të vogël se sa nevojitej?			
Ju ose ndonjë anëtar i familjes duhet të hani më pak vakte në dite?			

-  1. Familje me siguri ushqimore
-  2. Familje me nivel të moderuar të pasigurisë ushqimore
-  3. Familje me nivel të konsiderueshëm të pasigurisë ushqimore
-  4. Familje me nivel të lartë të pasigurisë ushqimore

2.3.2 Të dhënat cilësore

Shënimet e kryera gjatë intervistave gjysëm të strukturuar apo takimeve në grupe u analizuan duke përdorur teknikat e analizës cilësore, me qëllimin për të përmbledhur çështjet më të rëndësishme dhe më interesante të përmendura në intervista.

³ Coates, J., Swindale, A., & Bilinsky, P. (2007). Household Food Insecurity Access Scale (HFIAS) for measurement of food access: indicator guide: version 3. E aksesueshme online në lidhjen: http://www.fao.org/fileadmin/user_upload/eufao-fsi4dm/doc-training/hfias.pdf

3. Burimet, përdorimi i burimeve dhe potencialet e zhvillimit – të dhëna dytësore

3.1. Të dhëna të përgjithshme për bashkinë Kurbin

Bashkia e re e Kurbinit shtrihet në Shqipërinë qendrore dhe kufizohet në veri me bashkitë Lezhë dhe Mirditë, në lindje me bashkinë Mat, në jug me bashkitë Krujë dhe Durrës dhe në perëndim me Detin Adriatik. Krahina e Kurbinit shtrihet në veriperëndim të Shqipërisë së Mesme në zonën midis lumenjve Mat në veri dhe Drojë në jug. Kurbini ndodhet 45 km larg kryeqytetit, 65 km nga porti i Durrësit, 20 km nga porti i Shëngjinit dhe 40 km larg aeroportit Kombëtar të Rinasit “Nënë Tereza”.

Pjesa lindore e kësaj krahine është pothuajse e gjitha zonë malore, në të cilën dallohen dy vargmale të cilat ecin pothuajse paralel me njëri tjetrin, njëri prej të cilëve, ai lindor, është vargmali i Skënderbeut (22 km gjatësi), ndërsa tjetri vargmali perëndimor është vargmali Krujë – Dajt. Dy vargmalet i ndan në mes lumi i Hurdhazës që buron nga Mali i Skënderbeut në Vinjollë, kurse pjesa perëndimore është zonë fushore.

Sipas Censurit të vitit 2011, në territorin e bashkisë së re Kurbin ka 46,291 banorë, ndërsa sipas Regjistrimit Civil ka 72,987 banorë. Me një sipërfaqe prej 269.03 kilometrash katrorë, densiteti i popullsisë sipas të dhënave të Censurit 2011 është 172 banorë km², ndërsa sipas Regjistrimit Civil, densiteti është 271 banorë km².

Tabela 4. Të dhëna kryesore për Bashkinë Kurbin

Emërtimi	Vlera dhe njësia	Specifikime
Sipërfaqja e njësisë vendore	26,902 ha	S. Totale Urbane =1,555 ha S. Territori Bujqësor =9,814 ha S. Territori Natyror =809 ha S. Territori Infrastruktural=365 ha
Numri i popullsisë ekzistuese	72,987 banorë sipas Regjistrimit ose 46,291 banorë sipas Censurit	Bashkia merr në konsideratë tregues të ndryshëm.
Zona të rëndësishme kombëtare dhe zona të mbrojtura natyrore dhe kulturore	4024 ha	Sipas legjislacionit të posaçëm dhe lidhit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit
Sipërfaqe e miratuar zonash informale	149 ha	Zonat e miratuara nga ALUIZNI

Burimi: Plani i Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Kurbin (2017)

Në organizimin e ri administrativ, Kurbini ka 27 fshatra të shtrirë në katër njësi administrative, të cilat janë: Laçi, Mamurrasi, Miloti dhe Fushë-Kuqja (Tabela 5). Në këtë bashki ka tre qytete, Laçi, Miloti dhe Mamurrasi dhe 27 fshatra. Të gjitha janë njësi përbërëse të rrethit Kurbin, qarku Lezhë. Tabela 5 tregon fshatrat sipas njësive administrative.

Tabela 5: Njesitë e Bashkisë Kurbin

Njësia administrative	Qytetet dhe fshatrat nën juridiksion të bashkisë
Laç	Qyteti Laç, Fshatrat; Laç (Sanxhak)
Mamurras	Qyteti Mamurras, Fshatrat; Fushë-Mamurras, Shpërthet, Shëmri, Zhejë, Katund i Ri, Gjorm, Drojë
Milot	Qyteti Milot, Fshatrat; Skuraj, Mal Milot, Fush Milot, Mal Bardhë, Mal Bardhe i sipërm, Gallatë, Selitë, Gernac, Vinjoll, Shullaz, Prozhmë, Delbnisht, Ferr-Shkopet, Shkopet
Fushë-Kuqe	Fshatrat; Fushë - Kuqe, Adriatik, Patok, Gorre, Gurëz

Burimi: Plani i Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Kurbin (2017)

⁴ Për më shumë informacion shiko në lidhjen: <http://zgjedhje2015.reporter.al/profili-i-bashkise-kurbin/>

Sipas ndarjes së territorit, 52% e kësaj sipërfaqeje është nën sistemin natyror, rreth 33% është territor bujqësor ndërsa pjesa tjetër ndahet në territor urban (12%), infrastrukturor (0.22%) dhe ujqor (3%) (shiko [Tabela 6](#)). Gjithashtu, 4,024 hektar të Bashkisë Kurbin janë sipërfaqe toke e zonave të rëndësishme kombëtare dhe zonave të mbrojtura natyrore dhe kulturore. Në territorin e Bashkisë Kurbin ndodhet një zonë e mbrojtur natyrore, laguna e Patokut, e cila shtrihet mes grykëderdhjes së lumit Mat dhe pellgut të shkarkimit të hidrovorit të Adriatikut. Baseni i kënetës ka rreth 780 ha tokë, ndërsa vetë laguna ka 340 ha. Vlen të përmendet larmia e florës dhe faunës në zonë me lloje të ndryshme shpendësh, peshqish, bimësisë, të cilat janë një burim i vyer që ndikon në zhvillimin e turizmit në Ultësirën Perëndimore. Kjo hapësirë, së bashku me hapësirën baferike të parkut paraqesin burime të rëndësishme për rajonin. Pjesa më e madhe e territorit natyror të bashkisë është pjesërisht malore që ndodhet në Shqipërinë qendrore dhe ka një vijë bregdetare, që shtrihet në rezervatin natyror Patok-Fushë Kuqe.

Tabela 6: Pesë sistemet e territorit në Kurbin

Sistemi i përdorimit të tokës	Sipërfaqja ekzistuese	
	Në km ²	në %
Sistemi natyror	143.5	53.37
Sistemi ujqor	8.09	3.01
Sistemi bujqësor	98.1	36.48
Sistemi urban	15.6	5.78
Sistemi infrastrukturor	3.6	1.36

Burimi: Plani i Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Kurbin (2017)

Plani i Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Kurbin (2017) propozoi shtimin e dy Parqeve Natyrore Rajonale, njëri për territorin e Bjeshkëve të Tridhnës me sipërfaqe 1,327 ha dhe tjetri në Pyllin e Gështenjave pranë fshatit Selitë, me sipërfaqe 446 ha. Parku mendohet të jetë nën juridiksionin e Bashkisë Kurbin, kështu që i takon kësaj të fundit të kryejë studimin e nevojshëm dhe të ndjekë procedurën ligjore për aprovimin e statusit të Parkut Natyror Rajonal për këto dy zona.

Territori i Kurbin është i pasur me ujëra nëntokësore dhe sipërfaqësore. Hidrografia e bashkisë Kurbin përbëhet prej ujërave sipërfaqësore dhe ujërave nëntokësore që gjenden në akuiferët kryesorë të zonës në studim. Rrjeti hidrografik i rajonit përbëhet prej disa lumenjve, ku ndër më kryesorët janë: Lumi i Matit, Drini i Lezhës, lumenjtë Gjadër, Fani i Madh dhe Fani i Vogël. Lumi Mat është lumi më i rëndësishëm për furnizimin me ujëra nëntokësore të akuiferëve të Lezhës, Fushë - Kuqes, Milotit dhe Patokut. Zona ka gjithashtu dhe përranj si ai i Dorëzës, i Drojës dhe Ishmi që i shërben si kufi jugor. Shfrytëzimi i lumenjve për prodhimin e energjisë është potenciali kryesor me impakt të drejtpërdrejtë në zhvillimin e rajonit. Në zonën veriore të rajonit ndodhen edhe HEC-et kryesore të cilat furnizojnë me energji një pjesë të konsiderueshme të territorit të Shqipërisë (Ulza, Shkopeti, Fierza, Komani, Vau i Dejës, dhe Ashta).

Ujërat nëntokësore në territorin e rajonit ndodhen kryesisht në zhavorret ujëmbajtëse të akuiferit Fushë - Kuqe, Fushë - Milot, Laç. Shfrytëzimi intensiv i këtij akuiferi ka filluar që në vitin 1964. Përveç sasisë së ujërave nëntokësore që merren si në krahun verior të Lumit Mat, ashtu dhe në krahun jugor të zonës, zonë tjetër në perspektivë për marrjen e burimeve ujore suplementare është edhe grykëderdhja e vetë Lumit Mat.

Sipërfaqja totale e tokave bujqësore në Bashkinë Kurbin është 10,096 ha. Toka shumë e përshtatshme për kultivimin bujqësor të diversifikuar, çka kushtëzohet edhe nga fragmentimi i lartë. Diversiteti natyror në zonë krijon mundësitë për rritjen e bimëve mjekësore dhe aromatike, që përmbajnë lëndë aktive dhe esenca. Bimët mjekësore që rriten në këtë zonë janë: sherebela, trumza, kamomili, lulebliri, çaj mali, luleshtrydhe, lulëkuqja dhe mëllaga.

Në pikëpamje të ofertës, mungesa e fuqisë punëtore, kryesisht mungesa e moshave të reja përbën një kufizim të rëndësishëm. Një faktor tjetër negativ është edhe mungesa e mekanikës bujqësore, tregut të blerjes nga njësitë e përpunimit dhe mungesa e tregjeve ditore. Në tabelën e mëposhtme tregohen disa tregues të kapaciteteve potenciale të zonës ([Tabela 7](#)).

Tabela 7. Tregues të kapaciteteve prodhuese të zonës

Treguesit	F.Laç (Sanxhak)	Mamurras	Milot
1. Popullsia (nr. banorësh)	29,821	15,520	8,077
2. Popullsi nën moshë 40 Vjec (nr. banorësh)	:	0	5,156
3. Nr. familjesh	9858	4,330	1,877
4. Familje me ndihme ekonomike (%)	3.30%	3.90%	14.20%
5. Pjesa e familjeve që kane ikur nga fshati në 10 vite (%)	NA	10%	4%
6. Sipërfaqe e tokës bujqësore në total (ha)	1,423	3,596	2,272
7. Toka bujqësore e përdorur me akses në ujë (ha)	900	2,127	368
8. Sipërfaqja e kullotave (ha) nën përdorim të fshatit	250	117	NA
9. Sipërfaqja e pyjeve nën përdorim të fshatit (ha)	NA	584	9,626
10. Numri total i krerëve të gjedhit (krerë)	600	1,832	3,490
11. Numri total i krerëve të të imtave (krerë)	750	2,784	12,270
12. Mjete transporti (nr.)	30	0	23
13. Nr. traktorësh	15	30	8
14. Farmaci bujqësore (nr.)	3	1	0
15. Nr. baxhosh	0	1	0
16. Nr. restaurantesh	NA	5	12
17. Pika grumbullimi të produkteve bujqësore	1	0	0

3.2. Vizioni dhe objektivat strategjike

Vizioni i zhvillimit të Bashkisë Kurbin është i ndërtuar mbi tre shtylla kryesore të cilat janë prodhimi bujqësor, turizmi mjedisor dhe zhvillimi i qendrave urbane (Tabela 8). Shtylla e parë ka si prioritet rritjen e prodhimit bujqësor dhe përmirësimin e kërkesës për produkte. Prioriteti i parë, pra ai i rritjes së prodhimit bujqësor do të kryhet nëpërmjet përmirësimit të strukturave prodhuese si rehabilitimi i sistemit vaditës, rikuperimi dhe sistemimi i kanaleve kulluese dhe rritja e mundësive për kullimin. Në materialin e strategjisë së territorit janë renditur një sërë projektsh që ndikojnë në përmirësimin e rrjeteve teknike. Mbrojtje e akuiferëve, pastrimi i lumenjve dhe mbrojtja e tokave dhe njerëzve nga efektet e pritshme si rreziku nga prurjet e shpejta të ujit. Mbrojtja ndaj përmbytjeve nëpërmjet rehabilitimit të kanaleve ujitëse dhe rikuperimit të hidrovoreve si edhe ndërtimi i një qendre agrourbane për mbledhjen dhe shpërndarjen e prodhimeve agro-ushqimore pranë zonave të prodhimit kanë qenë dy veprimtari të planifikuara.

Prioriteti i dytë ka si qëllim përmirësimin e kërkesës urbane nëpërmjet ngjoitjes së një zone tregu me kilometër zero dhe zhvillimin e zixhirëve të shkurtër të furnizimit ushqimor. Kjo shtyllë zhvillimore mendohet të përplotësohet me turizmin mjedisor. Në Kurbin gjenden mjaft monumente kulturore, pjesë e trashëgimisë historike të territorit, që kanë status të veçantë dhe mbrohen në nivel kombëtar. Një objekt kulti me frekuentim të gjerë është Kisha e Shën - Ndojt në Laç, por gjithashtu me interes për vizitorët është Kalaja e Sebasties. Sipas ligjit nr. 9048 datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, objektet e mbrojtura të trashëgimisë kulturore kategorizohen në: objekte nën vërtim, objekt në mbrojtje paraprake, monument kulture i kategorisë II dhe monument kulture të kategorisë së I. Në këtë drejtim në afatin e shkurtër planifikoheshin ndërhyrje të integruara për shfrytëzimin e organizuar për qëllime turistike të zonës malore përreth liqenit artificial të Shkopetit, luginës së Patokut, zonës malore të Tridhnës e të tjera zonave me burime të pasura historike dhe njerëzore, që janë pjesë e vizionit të Bashkisë. Rehabilitimi dhe përmirësimi me qëllime turistike i rrugës që lidh disa fshatra të Kurbin të Vjetër për promovimin e resurseve etno-kulturore dhe produkteve agro-blegtole, përfshirë këtu shfrytëzim për turizëm natyror i ishullit të Cabakut janë në planet e zhvillimit të turizmit të natyrës dhe historisë. Këto ndërhyrje kërkojnë të lidhin një sërë sistemesh ekologjikisht të përshtatshme për shfrytëzim turistik nëpërmjet lëvizjes së ngadaltë siç e kërkon edhe jetesa rurale, si rrugë këmbësorësh, vizitë, objekte të vogla shërbimesh, pika vërtimi shpendësh, etj.

Tabela 8. Projektet për prodhimin bujqësor

	Afat-Shkurtër (Projekte Pilot)	Afat-Mesëm	Afat-Gjatë
Prodhim Bujqësor	Qendër agro-ushqimore me zinxhir të shkurtër	Rehabilitim dhe përmirësimi i sistemit të kanaleve kulluese	Rikuperimi dhe rritja e efikasitetit të hidrovoeve
	Zonë tregu lokal (aty ku nxirret produkti)	Rehabilitimi i sistemit të vaditjes në zonë fushore	
		Sistem biologjik i trajtimit të ujërave të zeza	
Turizëm Mjedisor	Rrugë me karakter turistik për në Kurbin të Vjetër	Shfrytëzimi turistik natyror i lagunës së Patokut	Zhvillimi me karakter turistik i liqenit të Shkopetit
	Shfrytëzim për turizëm natyror i ishullit të Cabakut	Zhvillim i zonës së Shën Ndout	Turizëm malor në Tridhnë
	Rrugë çiklizmi Laç/Patok		Zhvillim i turizmit bregdetar pranë fshatit Adriatik
Qendërzim Urban		Rikualifikim i qendrës urbane të Laçit	Zhvillim i shërbimeve në zonën e Fushës-Kuqes
		Rikualifikim i qendrës urbane të Mamurrasit	Zhvillim i zonave prodhuese
		Rikualifikim i qendrës urbane të Milotit	

Burimi: Plani i Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Kurbin (2017)

3.3. Përdorimi i burimeve të bashkisë

Në zonën e studimit kryejne aktivitetin e tyre rreth 7,800 ferma me orientim kryesisht bujqësor të cilat kanë në pronësi në total rreth 10 mijë hektar tokë dhe mbarështojnë rreth 9 mijë krere blegtori. Toka është shumë e përshtatshme për kultivimin bujqësor e për shkak të diversitetit të tipologjisë, ka bërë të mundur kryerjen e aktiviteteteve të lidhura me një sërë produktesh bujqësore e blegtorale (Tabela 9).

Tabela 9. Prodhimi bimor dhe shtazor

Përbërës niveli I		Përbërës niveli II	Prodhimi
Prodhimi bimor	Prodhimet e arave	Drithëra (Ton)	14,173
		Perime (Ton)	17,482
		Patate (Ton)	2,016
		Fasule (Ton)	899
		Bime industriale (Ton)	1
		Farogjere (Ton)	160,579
	Drufrutor	Peme frutore(Ton)	1,849
		Ullinj (Ton)	2,842
		Agrume (Ton)	108
		Rrush gjithsej (Ton)	2425

Prodhimi Blegtoral	Prodhimi Blegtoral	Qumësht (Ton)	25861
		Mish (Ton)	2351
		Lesh (Ton)	21
		Veze (Ton)	14313
		Mjaltë (Ton)	57

Burimi: Plani i Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Kurbin (2017)

Sistemi bujqësor lejon që rreth 40% nga toka bujqësore të përdoret për shkak të cilësive të mira dhe përdorimit ekzistues të sistemit vaditës. Klima e favorshme dhe ecuria e reshjeve në rajon, favorizojnë rrijen e kulturave të ndryshme bujqësore, e sidomos të vreshtave. Presioni i lartë i urbanizimit dhe humbja e tokës bujqësore për shkak të përmbytjeve të mundshme të përsëritura të lumenjve (pasojat ekonomike të rrezikut të pakontrolluar hidro-geologjike) dhe dëmtimi i zonave në nivelin e detit po sjell ndryshime strukturore. Këto probleme si edhe ato që vijnë nga mungesa e konsolidimit të një regjimi të qartë pronësie, janë dy sfidat më jetëgjata që ka përjetuar bujqësia në zonën e Bashkisë Kurbin (Tabela 10). Pozicionimi në afërsi të akseve rrugore më të rëndësishme kombëtare dhe prezenca veprave të mëdha energjitike e bën të gjerë gamën e mundësive zhvillimore në zonë si në aktivitetet bujqësore ashtu edhe në aktivitetet jo-bujqësore si tregtia dhe industria e lehtë përpunuese.

Tabela 10. Analiza SWOT - Sistemi bujqësor

Pikat e forta
<ul style="list-style-type: none"> • Bujqësia është një nga aktivitetet ekonomike kryesore të territorit • Territori i bashkisë përbëhet për rreth 40% nga toka bujqësore, të karakterizuara nga një cilësi e lartë e produkteve agroushqimore dhe mundësi të mira zhvillimi falë sistemit vaditës ekzistues • Klima e favorshme dhe ecuria e reshjeve në rajon, favorizojnë rrijen e kulturave të ndryshme bujqësore • Tradita e kultivimit të vreshtave • Prezenca e shembujve të mirë të aktivitetit agro-turistik
Pikat e dobëta
<ul style="list-style-type: none"> • Fragmentimi i lartë i pronave bujqësore, përmasa të vogla të prodhimit dhe të punësimit të ndërmarrjeve bujqësore lokale • Infrastrukturat e drenazhimit dhe të ujitjes janë të pa mirëmbajtura • Rënie e numrit të studenteve në degët e lidhura me bujqësinë dhe zootekninë • Territorët bujqësore zihen nga ndërtime të reja, si pasojë e një fenomeni të përhapur urbanizimi • Moshë mesatare e fermerëve rritet si pasojë e braktisjes nga ana e të rinjve e zonave historikisht • Mekanizmi i proceseve bujqësore nuk është i tillë për t'u bërë ballë nevojave të sektorit
Mundësitë
<ul style="list-style-type: none"> • Mundësia e rritjes së prodhimit në sera • Mundësia e eksportit të produkteve tipike bujqësore organike në tregjet lokale, në zonën metropolitane dhe në perspektivë, në tregjet e Ballkanit dhe vendeve të Adriatikut • Organizimi i fermerëve të vegjël dhe të mesëm në forma të shoqatave kooperative • Trajnimi dhe mbështetja për formimin e kopshteve urbane të shpërndara në zonat me marginalizim të madh dhe varfëri urbane • Krijimi i qendrave kërkimore në fushën agro-ushqimore dhe të edukimit në ushqim e mirëngrënie, madje edhe në sferën arsimore-edukative • Zhvillimi i një sistemi të ofertave të hotelarisë cilësore, i lidhur ky me vlerësimin e produkteve dhe traditave ushqimore lokale, kultivimin e peshkut dhe peshkimit
Rreziqet

- Rritja progresive e përdorimit të tokës bujqësore për banim, që sjell fragmentimin e tokave dhe përfitimit bujqësor
- Humbja e tokës bujqësore për shkak të përmytjeve të mundshme të përsëritura të lumenjve (pasojat ekonomike të rrezikut të pakontrolluar hidro-gjeologjike) dhe dëmtimi i zonave nën nivelin e detit, me pasoje modifikimin e ekosistemit
- Mungesë e integritimit me prodhimet bujqësore të zonave rurale të Lezhës dhe Durrësit, me krijimin e një tregu më të hapur
- Problem në zonat e karakterizuara nga mungesa e një regjimi të qartë pronësie
- Probleme në procesin e legalizimit të imigrantëve të parregullt

Burimi: Plani i Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Kurbin (2017)

4. Burimet, përdorimi i burimeve dhe potencialet e zhvillimit – të dhëna parësore

4.1 Burimet e bashkisë

4.1.1 Burimet njerëzore në bashkinë Kurbin

Përmasa e familjes

Përmasa mesatare e familjes së intervistuar në Kurbin është 5 antarë, dhe (sipas njësive bashkiake) e vendosur në intervalin 4.7 deri në 5.1 antarë (Tabela 11). Përmasa e familjes në Kurbin duket se është paksa më e madhe se përmasa e familjes në zonën e projektit.

Tabela 11: Familjet e intervistuar, popullsia koresponduese dhe përmasa e familjes

Treguesit	Laç	Mamurras	Milot	Kurbin	Zona e projektit
Numri i familjeve të intervistuar	7	70	29	106	439
Numri i popullsisë që i korespondon familjeve të intervistuar	36	360	135	531	2115
Përmasa mesatare e familjes	5.1	5.1	4.7	5.0	4.8

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

Mosha mesatare, struktura moshore dhe raporti i varësisë

Mosha mesatare në Kurbin, 37.1 vjeç (35.5 vjeç pa vlerat ekstreme), është e më e lartë se mosha mesatare për zonën e projektit (35 vjeç, dhe 34.1 vjeç pa vlerat ekstreme) (shih Tabela 12 dhe referoju Tabela 42 në Aneks për më shumë detaje).

Tabela 12: Mosha mesatare sipas njësive administrative

Zona e Programit	Kurbin				Zona e projektit
	Njesia Administrative			Totali	
	Laç	Mamurras	Milot		
Mesatarja	37.7	37.7	35.5	37.1	35.0
Mesatarja pa vlerat ekstreme	37.1	37.0	35.1	36.5	34.1
Mediana	35.0	35.0	30.5	34.0	32.0

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

Struktura e përmbledhur e popullsisë që i korespondon familjeve të intervistara në bashkinë Kurbin, mund të karakterizohet nga tre tipare: (i) normë mesatare varësie (raporti popullsi jo në moshë pune me popullsinë në moshë pune), (ii) proporcion më të ulët të fëmijëve krahasuar si me zonën e projektit, ashtu edhe me vendin, si dhe (iii) proporcion i popullsisë në moshë pensioni mes proporcionit të zonës së projektit dhe vendit, Tabela 13. (Për detaje të strukturës së popullsisë, referoju Tabela 42, në Aneks). Propocioni më i ulët i fëmijëve dhe relataivisht i lartë i popullsisë në moshë pensioni përban riskun e përkeqësimit të raportit të varësisë.

Tabela 13: Struktura moshore e popullsisë së intervistuar ne Kurbin, zonën e projektit dhe vendin

Struktura	Struktura në %		
	Kurbin	Zona	Vendi
Deri në 14 vjeç	16.4	20.6	16.8
15 deri ne 64 vjeç	71.5	69.9	68.4
Mbi 65 vjeç	12.1	9.5	14.8
Totali	100	100.0	100
N	529	2016	2,845,955

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

Bashkia Kurbin karakterizohet nga një normë mesatare e varësisë⁵ – Norma e varësisë në Kurbin është 40 persona të varur nga 100 vetë popullsi në moshë pune. Kjo normë varësie është qartësisht më e ulët se ajo për vendin por paksa më e lartë se për zonën e projektit, respektivisht 46 dhe 38, [Tabela 14](#).

Tabela 14: Raporti i varësisë në bashkinë Kurbin, zonën e projektit dhe vendin

	Njësia administrative			Kurbin	Zona e projektit	Vendi
	Laç	Mamurras	Milot			
Raporti i varësisë	38	45	28	40	38	46

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

Përbërja gjinore

Popullsia që i korrespondon familjeve të intervistuar përbëhet nga 45% femra dhe 55% meshkuj, një strukturë qartësisht në favor të meshkujve. Ky fenomen është më i theksuar ne Milot dhe Mamurras, por i përmbysur në Laç, ku femrat dominojnë në strukturën e popullsisë ([Tabela 15](#)). Përbërja gjinore në bashkinë Kurbin duket se ndryshon nga përbërja gjinore për zonën e projektit për shkak të dominimit më të madh të meshkujve ndaj femrave. Fenomeni i reduktimit të numrit të femrave dhe përmbysjes së raporteve gjinore vihet re edhe në zona të tjera të vendit. Martesa, nevoja për edukim dhe punësimi ka sjellë një lëvizje të njëanshme të kësaj gjinie.

Tabela 15: Struktura gjinore e popullsisë së intervistuar

Gjinia	Laç		Mamurras		Milot		Totali Kurbin		Zona e projektit	
	Numër	%	Numër	%	Numër	%	Numër	%	Numër	%
Femër	19	53%	159	44%	59	44%	237	45%	993	47%
Mashkull	17	47%	199	56%	76	56%	292	55%	1117	53%
Total	36	100%	358	100%	135	100%	529	100%	2110	100%


Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

Niveli arsimor

Arsimi deri tetëvjeçar (fillor dhe 8 vjeçar) përbën nivelin më të shpeshtë të arsimit në bashkinë Kurbin (57% e popullsisë prej që i korrespondon familjeve të intervistuar ka arsim deri tetëvjeçar), proporcion më i ulët krahasuar me proporcionin me arsim deri 8 vjeçar në zonën e projektit (65%), [Figura 1](#). Sipas njësive bashkiake, arsimi deri 8 vjeçar bie në intervalin 51% (Milot) dhe 61% (Laç).

⁵ Norma e varësisë llogaritet duke mbledhur përqindjen e fëmijëve (të moshës deri në 15 vjeç), dhe përqindjen e popullsisë në moshën e pensionit (mbi 65 vjeç), dhe kjo shumë pjestohet me përqindjen e popullsisë në moshë pune (të moshës 15-64 vjeç). Rezultatit e shumëzoni me 100, kështu që rezultati shprehet si numër i personave të varur për çdo 100 vetë në moshë pune.

Figura 1: Struktura arsimore e popullsisë së intervistuar



Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

Nga ana tjetër, pjesa e popullsisë më arsim mesëm është në mënyrë domethënëse më e lartë së ajo e zonës së projektit (35% përkundrejt 25%). Pjesa e popullsisë me arsim të lartë është e njëjtë me zonën e projektit por me diferenca të mëdha mes njërive bashkiake 6% në Mamurras përkundrejt 11% në Laç dhe 12% në Milot.

4.1.2 Burimet natyrore prodhuese në bashkinë Kurbin

Toka në pronësi

Sipërfaqja mesatare e tokës në pronësi për bashkinë Kurbin është 13 dym, ndërsa sipërfaqja mesatare e tokës në pronësi pa vlerat ekstreme është 12 dym. Nga të dhënat në [Tabela 16](#), del se disponibiliteti i tokës në pronësi për familje fermere të intervistuar në Kurbin është në mënyrë të ndjeshme mbi mesataren e zonës së projektit – sipërfaqja mesatare në pronësi dhe ajo mesatare pa ekstremet në zonën e projektit është respektivist 8.4 dhe 7.7 dym (Tabela 16). Nga informacioni i mbledhur në intervistat gjysëm të strukturuar u vu re se treguesit e sipërfaqes për frymë mendoheshin më të ulët. Mundet, që sipërfaqet *defacto* në pronësi të jenë më të larta, si shkak edhe i dinamikës së levizjeve të familjeve në fshatra.

Tabela 16: Të dhëna mbi tokën në pronësi

Treguesit	Kurbin				Zona e projektit
	Njësia Administrative			Total	
	Laç	Mamurras	Milot		
Mesatarja	13.9	15.0	7.8	13.0	8.4
Mesatarja pa 5% vlera ekstreme	13.7	13.9	7.5	12.0	7.7
Mediana	17.0	12.0	9.0	10.0	7.0

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

Toka e përdorur

Sipërfaqja mesatare e tokës së përdorur (që mund të konsiderohet si proksi për përmasën e fermës) për bashkinë Kurbin është 19.3 dynym, ndërsa sipërfaqja mesatare e tokës në pronësi pa vlerat ekstreme është 17.4 dynym. Sipërfaqja mesatare e tokës së përdorur (ose përmasa e fermës) në Kurbin është qartësisht më e lartë se mesatarja për zonën e projektit, **Tabela 17**. Ndërkaq, diferencat mes njërive bashkiake janë të ndjeshme – Mamurras pothuaj në mesataren e zonës së projektit, Laçi më shumë se dyfishi i mesatares së zonës së projektit dhe Miloti ndjeshëm nën zonën e projektit.

Tabela 17: Të dhëna mbi tokën e përdorur

Treguesit	Kurbin				Zona e projektit
	Njësia Administrative			Total	
	Laç	Mamurras	Milot		
Mesatarja	45.4	19.6	14.4	19.8	12.2
Mesatarja pa 5% vlera ekstreme	44.2	18.0	10.3	17.4	10.1
Mediana	47.0	15.0	10.0	14.0	8.0

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

Tregu i qerasë

Një numër i konsiderueshëm i familjeve të intervistuar (më shumë se një e treta e familjeve ose 35%) në Kurbin marrin tokë me qira. Propocioni i familjeve që marrin tokë me qira në Kurbin është i qartësisht më i lartë se për zonën e projektit ku 29% e familjeve marrin tokë me qira (**Tabela 18**). Nga ana tjetër, numri i familjeve që japin tokë me qira është i vogël (6% sipër Kurbinin); ky propocion është më i lartë se për zonën e projektit. Sipërfaqja totale e marrë me qira për zgjedhjen në Kurbin është 786 dynym ndërsa për zonën e projektit 1744.2 dynym. Mesatarja e transaksionit për Kurbinin është 21.4 dynym, dukshëm më e lartë se për zonën e projektit (13.7 dynym). Toka merret me qera kryesisht për nga fermat blegtorale prodhimin e ushqimit të blegtorisë (jonxhë dhe misër) (burimi: grupi i fokusuar). Shifrat mund të merren me kujdes duke konsideruar që janë marrë në distancë.

Tabela 18: Të dhëna mbi tregun e qerasë në Kurbin dhe zonën e projektit

Treguesit	Kurbin		Zona e projektit		
	Tokë dhënë me qira	Tokë marrë me qira	Tokë dhënë me qira	Tokë marrë me qira	
1	Familje që marrin/japin tokë me qera	6	37	15	127
2	Familje të intervistuar	106	106	439	439
3	Përqindje (1/2) *100	6%	35%	3%	29%
4	Mesatarja (Dynym)	9.2	21.2	6.4	13.7
5	Sipërfaqja totale (Dynym)	55.0	786.0	95.6	1744.2
7	Minimumi (Dynym)	3.0	2.0	1.0	0.5
8	Maksimumi (Dynym)	15.0	120.0	15.0	130.0

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar


Vlerësimi mbi burimet më të rëndësishme natyrore prodhuese

Sipas perceptimit të fermerëve të intervistuar, burimet më të rëndësishme në bashkinë e Kurbinin janë toka bujqësore⁶ (më shumë se dy të tretat e subjekteve të intervistuar (68.9%) vlerësojnë se toka bujqësore përbën burimin më të rëndësishëm natyror prodhues), pyjet (20.8% e të intervistuarve konsiderojnë pyjet si burim të parë më të rëndësishëm), livadhet dhe kullotat (më shumë se 1/3 e

⁶Sipas përkufizimit të INSTAT, toka bujqësore e përdorur përfshin tokën e punueshme (arë), tokën e zënë me kultura drufrutore, kopshtet e shtëpive dhe kullotat e livadhet.

fermerëve konsiderojnë ato si burimin e dytë më të rëndësishëm). Burime të tjera të rëndësishme janë edhe liqenet e lumenjtë dhe zanatet, Figura 2.

Figura 2: Perceptimet e fermerëve mbi burimet natyrore në bashkinë Kurbin



Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vërtetimit të strukturuar

Vlerësimi për rëndësinë e tokës bujqësore të përdorur në Kurbin duket të jetë më i ulët se vlerësimin nga fermerët e zonës së projektit (68.9 e e fermerëve në Kurbin vlerësojnë tokën bujqësore si burimin më të rëndësishëm përkundrajt 79% të fermerëve të zonës së projektit). Nga ana tjetër, duket qartë se pyjet janë më rëndësishëm në Kurbin se në zonën e projektit (20.8% e fermerëve të Kurbin konsiderojnë pyjet si burimin më të rëndësishëm përkundrajt vetëm 9.3% në zonën e projektit), ndërsa kullotat (e livadhet) janë krahasimisht më pak të rëndësishme se për pjesën tjetër të zonës së projektit (35.8% e fermerëve në Kurbin konsiderojnë se kullotat janë burimi më i rëndësishëm përkundrajt 50.3% e fermerëve të zonës së projektit).

Pjesëmarrësit në grupin e fokusuar konfirmojnë se toka bujqësore, pyjet, livadhet e kullotat dhe burimet ujore janë katër burimet më të rëndësishme prodhuese në bashkinë e Kurbin. Ndërkaq, zanatet nuk vlerësohen si një burim i rëndësishëm në Kurbin.

Bashkia Kurbin posedon një rezervuar të madh – rezervuari i Zhejës. Rezervuari ka potenciale të mëdha ujitjeje. Kapaciteti mbajtës i rezervuarit është 3 milionë m³. Lumi i Lezhës përfaqëson gjithashtu një pasuri të madhe ujore për tu përdorur kryesisht për ujitje. Ndërkaq, si uji rezervuarit, ashtu edhe ai i lumit të Lezhës aktualisht nuk përdoren për shkak se sistemi i ujitjes (kanalet e dytë dhe të tretë) nuk janë funksionale. Sistemi jo-funksional i ujitjes përbën një pengesë të madhe për zhvillimin e bujqësisë në bashkinë Kurbin.

Problem i rëndësishëm mbetet gjithashtu përmytja e tokave për shkak të dëmtimit të kanave të ujrave të larta të ndërtuar për të disiplinuar ujrat e përrrenjeve por që aktualisht janë jo-funksionale. Erozioni dhe kripezimi nuk konsiderohen problematike për zonën.

Sipas vlerësimit të përfaqësuesve të njësive bashkiake, toka bujqësore konsiderohet si burimi më i rëndësishëm prodhues në dy njësi bashkiake (Mamurras dhe Milot), ndërkohë që njësi bashkiake e Laçit konsideron bregdetin si burimin më të rëndësishëm. Livadhet dhe kullotat e pyjet konsiderohen si burimi i dytë më i rëndësishëm në Mamurras e Milot dhe peizazhet konsiderohet si burimi i dytë më i rëndësishëm në Laç. Toka bujqësore është burimi i tretë më në Laç, pyjet në Mamurras dhe peizazhet në Milot.

Si konkluzion i vlerësimit nga fermerët (intervistat e strukturuar), pjesëmarrësit në grupet e fokusuar dhe përfaqësuesit e njësive bashkiake, rezultojnë se tre burimet më të rëndësishme janë toka bujqësore, livadhet e kullotat dhe pyjet. Burimet ujore në trajtën e liqeneve, lumenjve dhe bregdetit duket se është gjithashtu një burim i rëndësishëm prodhues për bashkinë Kurbin. Nga ana tjetër, edhe peizazhet natyrore përmenden si burime potenciale.

5. Shfrytëzimi i burimeve të bashkisë

5.1. Prodhimi në fermë

Në bashkinë Kurbin kultivohen kryesisht drithërat, foragjeret dhe perimet e fushës, por gjithashtu zona ka prani të lartë të vreshtave dhe ullinjve (veçanërisht në Mamurras dhe Milot). Nga analiza e të dhënave të grumbulluara rezultojnë se mesatarisht për familjet e anketuara në Kurbin që kultivojnë perimet e fushës (86%) madhësia mesatare për fermë është 2 dynym, e atyre me vreshta është 1.4 dynym ndërsa për ullishtet është 3.2 dynym (kjo e fundit duket e lartë për shkak të konvertimit të numrit ekzistues të rrënjëve në zonat kodrinore). Për më tepër vëmë re se gruri, misri dhe foragjeret janë produktet më sipërfaqet më të mëdha për fermë në Kurbin (7.8, 4.1 dhe 7.5 dynym respektivisht) duke rezultuar kështu dyfishi i madhësive respektive për të gjithë observimet e studimit (zonën e projektit) (Tabela 19). Nëse marrim në konsideratë madhësinë e fermave në nivel njësie për këto produkte specifike, vëmë re se sipërfaqet për drithërat dhe foragjeret kanë peshë më të madhe se produktet e tjera të kultivuara dhe janë mesatarisht në nivel më të lartë se zona e projektit. Përdorimi i grurit për bukë është i avantazhuar në zonë duke konsideruar sipërfaqet fushore dhe aksesin në ujë në pjesët e ultësirës.

Tabela 19: Mesatare e sipërfaqeve të tokës kultivuar me produktet specifike të zonës dhe pjesa e fermerëve që prodhojnë këto produkte sipas njësive administrative dhe në total - Kurbin

Produkti	Kurbin								Zona e projektit	
	Njësia Administrative						Total			
	Laç		Mamurras		Milot		Dyn/fermë	%	Dyn/fermë	%
	Dyn/fermë *	%**	Dyn/fermë	%	Dyn/fermë	%				
Grurë	12.6	86%	6.8	24%	8.0	17%	7.8	26%	3.7	35%
Misër	6.5	86%	4.2	70%	3.1	62%	4.1	69%	2.6	64%
Perime fushe	1.0	71%	1.0	87%	1.0	83%	1.9	86%	1.1	61%
Foragjere	24.8	57%	6.8	54%	4.3	52%	7.5	54%	3.9	49%
Vreshta	:	0%	1.0	50%	9.3	55%	1.4	48%	1.4	30%
Ullinj	:	0%	3.6	76%	1.5	24%	3.2	57%	3.2	14%

Shënim: *Mesatarja; **Pjesa e fermerëve që prodhojnë produktin respektiv.

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

Zona ka orientim të mirë drejt drithërave dhe foragjereve. Duket qartë se prodhimi i ultësirës i bën fermerët të aftë të sigurojnë ushqimin e tyre dhe të blektorisë që mbarështojnë, kryesisht gjedhit. Prodhimi i grurit është tre herë më i lartë se zona e projektit. Prodhimi i perimeve është 3 herë më i ulët ndërsa prodhimi i vreshtave është i krahasueshëm me mesataren e projektit. Duke ditur se sasia e grurit për nevoja buke për frymë është diku 120-130 kg dhe sasia e perimeve mbi 180 kg për frymë mund të themi se aksesin në vetëpërbushje për drithëra është i arritur ndërsa në perime është i pjesshëm (Tabela 20). Meqenëse Kurbin është e vetmja zonë e projektit që prodhon ullinj atëherë mesatarja është e barabartë me zonën e projektit.

Tabela 20: Prodhimi drithërove, perimeve, vreshtave dhe ullinjve

Produkti	Treguesi	Kurbin				Zona e projektit
		Njësia Administrative			Total	
		Laç	Mamurras	Milot		
Grurë	Prodhimi (kv/fermë)*	49.7	38.8	38.2	37.3	14.9
	Kg/frymë	903.7	685.4	916.0	729.0	350.0
Perime fushe	Prodhimi (kv/fermë)*	3.7	6.1	4.4	5.4	12.8
	Kg/frymë	72.6	137.1	101.9	121.0	292.0
Vresht /rrush	Prodhimi (kv/fermë)*	:	6.1	14.9	8.4	7.2
	Kg/frymë	:	141.4	345.0	188.0	154.5
Ullinj	Prodhimi (kv/fermë)*	:	11.1	3.4	9.3	9.3
	Kg/frymë	:	222.8	61.4	190.5	190.5

*Mesatarja

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

Gjithashtu sasia e ushqimit për kafshët është e më e lartë se pjesa e tjetër e zonës së projektit, duke qenë se një pjesë e prodhimit gjendet në fushë. Në këtë rast vihet re vlera të ngjashme të rendimentit të jonxhës me mesatares e zonës së projektit (Tabela 21). Nisur nga kjo shkallë prodhimi dhe nga hapësira e sipërfaqes për fermë, duke se nuk ka mundësi për rritjen e lehtë të numrit të krerëve.

Tabela 21: Rendimenti mesatar

Produkti (Rendimenti (kv/ha)*)	Kurbin			Total Bashkia	Zona e projektit	Kurbin (INSTAT, 2020)
	Njësia Administrative					
	Laç	Mamurras	Milot			
Miser	57.8	58.4	61.5	57.8	54.0	65.9
Foragjere	45.1	63.6	109.6	68.4	64.2	396.2
Grurë	40.0	48.2	48.6	48.7	41.0	40.0

Shënim: Rendimenti mesatar i korrektuar

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

Mesatarisht, 25% e fermerëve tregtues në Kurbin shesin rreth 26% të prodhimit të tyre të grurit, më tej, 52% e fermerëve në Kurbin tregtojnë rreth 29% të prodhimit të tyre të misrit. Gjithashtu 59% e fermerëve tregtojnë rreth 33% të prodhimeve të tyre me perime fushe. Specifikisht sipas njësive vëmë re se në secilën njësi të katërta këto produkte tregtohen në një masë të madhe pra më shumë se gjysma e fermerëve në secilën njësi adm. (Tabela 22). Prodhimi i foragjereve mbahet për nevojat e fermës. Ajo çka vihet re është se orientimi i fermerëve drejt tregut është shumë më i lartë në zonën e Laçit për shkak të afërsisë nga tregu (numri i fermave që përgjigjen është i ulët kështu që treguesi duhet të shihet me kujdes).

Tabela 22: Shitja si përqindje ndaj prodhimit për produktet specifike të zonës dhe pjesa e fermerëve që i tregtojnë këto produkte sipas njësive administrative dhe në total për bashkinë Kurbin

Produkti	Kurbin						Total		Zona e projektit	
	Njësia Administrative									
	Laç		Mamurras		Milot					
	Shitje/ Prodhim (%)	%*	Shitje/ Prodhim (%)	%*	Shitje/ Prodhim (%)	%*	Shitje/ Prodhim (%)	%*	Shitje/ Prodhim (%)	%*
Grurë	44%	86%	24%	26%	13%	17%	26%	25%	22%	32%
Misër	22%	86%	27%	60%	31%	48%	29%	52%	15%	58%
Perime fushe	35%	71%	31%	60%	33%	52%	33%	59%	28%	45%
Foragjere	:	43%	16%	51%	17%	48%	20%	45%	13%	40%

Shënim: *Pjesa e fermerëve që e tregtojnë produktin respektiv.

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

5.2. Prodhimi i produkteve të përpunuara në fermë

Sa i përket prodhimit dhe tregtimit të produkteve të përpunuara në fermë si raki, verë, turshi apo reçel e të ngjashme me të, fermerët në secilën njësi administrative i përpunojnë këto produkte në fermë përveç njësisë Laç ku përpunohet vetëm rakia. Për shembull afërsisht 1/3 e fermerëve në Mamurras dhe Milot përpunojnë verë në fermë dhe rreth gjysmën e prodhimit e tregtojnë. Ndërsa për rastin e rakisë, përpunimi i saj nëpër ferma është më i përhapur ku më shumë se gjysma e prodhuesve në Kurbin prodhojnë mesatarisht 187 l raki për fermë (dhe mesatarisht 57% të saj e tregtojnë) (Tabela 23 për produktet e tjera të përpunuara në zonë).

Tabela 23: Prodhimi i produkteve të përpunuara në fermë, pjesa e fermerëve që prodhon dhe pjesa e shitur e prodhimeve sipas njësisë administrative dhe në total

Produkti	Treguesi	Kurbin				Zona e projektit
		Njësia administrative				
		Lac	Mamurras	Milot	Totali	
	Totali i observimeve	7	70	29	106	439
Verë	Pjesa e fermerëve që prodhojnë	0%	27%	34%	27%	23%
	Mesatarja e prodhuar (l)	:	61	118	88	75
	Përqindja e shitjeve	:	44%	50%	46%	68%
Raki	Pjesa e fermerëve që prodhojnë	29%	61%	52%	57%	45%
	Mesatarja e prodhuar (l)	100	115	212	187	87
	Përqindja e shitjeve	50%	74%	78%	73%	78%
Turshi	Pjesa e fermerëve që prodhojnë	0%	44%	24%	36%	48%
	Mesatarja e prodhuar (kg)	:	39	76	47	42
	Përqindja e shitjeve	:	:	:	:	74%
Reçel e të ngjashme	Pjesa e fermerëve që prodhojnë	0%	39%	28%	33%	48%
	Mesatarja e prodhuar (kg)	:	36	31	34	40
	Përqindja e shitjeve	:	:	:	:	74%
Trahana, jufka, petka etj.	Pjesa e fermerëve që prodhojnë	0%	26%	74%	17%	20%
	Mesatarja e prodhuar (kg)	:	8	:	8	13
	Përqindja e shitjeve	:	:	:	:	66%

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vërtetimit të strukturuar

5.3. Aktivitetet blegtorale të fermës

Fermtat blegtorale në njësitë e zgjedhura administrative të Kurbinut kryesisht janë të përfshira në aktivitetet blegtorale të gjedhit (65% e të anketuarve), shpendëve (82%), derrave (36%), të imtave (28%); ndërkohë vetëm 9% e familjeve janë angazhuar me bletërritjen (në Milot dhe Laç 14%). Rezultatet tregojnë se shumica e fermerëve të anketuar në Laç, Milot dhe Mamurras kanë të paktën një lopë për fermë, 5 krerë dele/fermë, 8 krerë dhi/fermë, 3 krerë derra/fermë dhe 8 koshere bletësh për fermë. Sa i përket shpendëve, mesatarisht një fermë në këto zona ka rreth 26 krerë shpendë (Tabela 24).

Tabela 24: Fermtat që merren me aktivitetet blegtorale dhe nr. i krerëve për fermë sipas njësisë administrative dhe në total për Bashkinë Kurbin

	Kurbin								Zona e projektit	
	Njësia Administrative						Total (N=106)			
	Laç (N=7)		Mamurras (N=70)		Milot (N=29)					
	%*	krerë/fermë*	%*	krerë/fermë**	%*	krerë/fermë**	%*	krerë/fermë**		
Lopë	86%	3	59%	2	76%	2	65%	1	62%	1
Dele	0%	-	10%	4	7%	-	8%	5	11%	6
Dhi	14%	-	21%	3	21%	41	21%	8	13%	5


Derra	57%	3	26%	2	55%	3	36%	3	11%	2
Shpendë	100%	34	77%	25	90%	28	82%	26	63%	21
Bletë (Koshere)	14%	-	7%	4	14%	12	9%	8	10%	6

Shënim: *Përqindja e fermave që kanë lopë/shpendë; **Nr. mesatar i krerëve për fermë.

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vërtetimit të strukturuar

Numri i krerëve për fermat që merren me blegtori nuk ka qenë shumë i luhatshtëm gjatë 5 viteve të fundit. Rezultatet tregojnë se madhësia e fermës në terma të numrit të krerëve gjatë 5 viteve të fundit për shumicën e blegtorëve nuk ka ndryshuar (pavarësisht nënsektorit). Duket se vetëm për 36% të bletarritësve në Kurbin, numri i koshereve për fermë ka pësuar ulje në 5 vitet e fundit; ndërsa për 33% të blegtorëve të gjedhit ka patur ulje apo ulje të mëdha në numrin e krerëve të lopëve për fermë gjatë 5 viteve të fundit. Sa i përket krerëve të shpendëve duket se për 26% të fermave me shpendë ka patur ulje dhe ulje të mëdha në zonë (Figura 3). Rënia e numrit të gjedhit nuk është e ndjeshme e vjen si rrjedhojë e plakjes graduale të popullsisë dhe ikja e krahit të punës. Rritja e moshës mesatare të familjeve sjell uljen e numrit të krerëve të mbajtur për mbarështim. Rënia e numrit të koshereve ndërkohë ka qenë e ndikuar nga rritja e sëmundshmërisë në vitet e fundit, si pasojë edhe e luhatjeve të forta në reshje.


Figura 3: Ecuria e numrit të krerëve për fermat gjatë 5 viteve të fundit – Kurbin



Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vërtetimit të strukturuar

Rezultatet e analizës përshkuese tregojnë se për shumicën e popullatës së anketuar, në 5 vitet e fundit numri i krerëve të lopëve, dhenve, derrave, shpendëve dhe koshereve për fermë në Laç nuk ka ndryshuar (shiko Figura 4 për përqindjet).

Figura 4: Ecuria e numrit të krerëve për fermat gjatë 5 viteve të fundit – Njësia administrative Laç




Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vërtetimit të strukturuar

Për fermat blegtorale në Mamurras të dhënat e grumbulluara tregojnë se për 30% të blegtorëve që mbarështojnë gjedh numri i krerëve të lopëve gjatë 5 viteve të fundit ka rënë. Sa i përket shpendëve ka

rënie për 29% të të anketuarve kurse për bleta-rritësit duket se për shumicën e tyre (60%) numri i koshereve për fermë ka rënë gjatë 5 viteve të fundit (Figura 5).


Figura 5: Ecuria e numrit të krerëve për fermat gjatë 5 viteve të fundit – Njësia administrative Mamurras



Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vërtetimit të strukturuar

Figura e mëposhtme paraqet ecurinë e numrit të krerëve gjatë 5 viteve të fundit për fermat e anketuara të njësive administrative Milot. Ngjashëm si në njësitë e tjera dhe në Milot aktivitetet blegtorale janë të diversifikuara. Të dhënat e grumbulluara tregojnë se për shumicën e blegtorëve të anketuar të zonës ecuria e numrit të krerëve të blegtorisë (pavarësisht llojit) nuk ka patur ndryshim ose është rritur gjatë 5 viteve të fundit (Figura 6).

Figura 6: Ecuria e numrit të krerëve për fermat gjatë 5 viteve të fundit – Njësia administrative Milot




Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vërtetimit të strukturuar

5.4. Aksesit në treg

Ecuria në vlerën e shitjeve krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019 nuk ka ndryshime të dukshme në shitje, përveç ndryshimeve të lehta që mund të vijnë nga ndryshimet e kushteve klimaterike. Në total, në bashkinë Kurbin, ashtu si dhe specifikisht në secilën njësi administrative, ecuria e vlerës së shitjes së produkteve si misri, gruri, perime fushe dhe foragjere, për shumicën e prodhuesve ka qenë e njëjtë krahasuar me vitin 2019. Pjesa e fermerëve që kanë patur shitje në rritje është e pakët për bimët e arave ndërsa pjesa e atyre që kanë patur ulje apo ulje të mëdha të vlerës së shitur të prodhimeve të tyre varion mes 20- 30% të të anketuarve sipas produkteve (Figura 7).


Figura 7: Ecuria në vlerën e shitjeve të produkteve krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019 – Total Kurbin



Shënim: Për përqindjet e observimeve të vlefshme shiko Tabela 22; Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

Rezultatet nga analiza përshkuese e të dhënave të grumbulluara tregojnë se në njësinë administrative Laç, ecuria e vlerës së shitjes së produkteve si misri, gruri, perime fushe dhe foragjere për shumicën e prodhuesve ka qenë e njëjtë krahasuar me vitin 2019. Për më tepër, 17% të anketuarve në Laç që kultivojnë dhe tregojnë grurë kanë përjetuar rritje të mëdha në vlerën e shitjeve për këtë produkt (Figura 8).


Figura 8: Ecuria në vlerën e shitjeve të produkteve krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019 - Laç



Shënim: Për përqindjet e observimeve të vlefshme shiko Tabela 22; Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar.

Për rastin e njësisë Mamurras, rezultatet e analizës përshkuese tregojnë se për shumicën e prodhuesve të këtyre produkteve në këtë njësi ecuria e vlerës së shitjeve të prodhimeve të tyre ka qenë mesatarisht e njëjtë por për përqindje të ulëta ka patur dhe ulje të vlerës së shitur. Për shembull 44% e tregtuesve të grurit kanë patur ulje dhe ulje të mëdha sa i përket vlerës së shitur krahasuar me po të njëjtën periudhë të vitit të kaluar (Figura 9).


Figura 9: Ecuria në vlerën e shitjeve të produkteve krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019 – Mamurras



Shënim: Për përqindjet e observimeve të vlefshme shiko Tabela 22; Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

Në rastin e njësisë administrative Milot të dhënat rezultojnë të njëjta me dy rastet e mësipërme. Për shumicën e prodhuesve dhe tregtuesve të grurit, misrit, foragjereve dhe perimeve të fushës, vlera e shitjeve ka qenë e njëjtë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019 (Figura 10).

Figura 10: Ecuria në vlerën e shitjeve të produkteve krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019 - Milot



Shënim: Për përqindjet e observimeve të vlefshme shiko Tabela 22; Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

5.5. Të ardhura të krijuara dhe burimet e të ardhurave

Të ardhurat nga ferma janë burimi kryesor i të ardhurave në Kurbin. Rreth 80% e fermerëve kanë të ardhura nga ferma, çka zë rreth 60% të të ardhurave të familjes. Të ardhurat nga blegtoaria janë më të larta se ato nga bujqësia. Shitja e qumështit dhe mishit, kryesisht të gjedhit, zënë një rëndësi më të lartë se shitjet bujqësore, përfshirë këto edhe mallrat e përpunuara (për shkak të sasisë së kufizuar). Rreth 80% e fermerëve tregojnë që kanë të ardhura jashtë fermës të cilat zënë më pak se një e treta e të ardhurave vjetore në familje. Njësia administrative Mamurras tregon një nivel më të lartë të prurjeve nga jashtë fermës, ku emigracioni luan një rol të rëndësishëm (Tabela 25). Nuk raportohen remitanca nga njësitë e tjera administrative.

Tabela 25: Të ardhurat e familjeve në përqindje sipas burimit në Kurbin dhe sipas njësive administrative

Treguesi	Kurbin				Total Kurbin	Zona e projektit
	Njësia administrative	Laç	Mamurras	Milot		
	Totali i observimeve	7	70	29	106	439
Të ardhura nga blegtoaria	Pjesa e fermerëve që kanë të ardhura	86%	57%	72%	63%	58%
	% (mesatare)	49%	36%	67%	44%	33%

Të ardhura nga bujqësia	Pjesa e fermerëve që kanë të ardhura	86%	54%	76%	62%	62%
	% (mesatare)	32%	17%	54%	25%	32%
Të ardhura nga aktivitetet grumbullimi	Pjesa e fermerëve që kanë të ardhura	0%	0%	0%	0%	11%
	% (mesatare)	0%	0%	0%	0%	5%
Totali i të ardhurave nga ferma	Pjesa e fermerëve që kanë të ardhura	86%	79%	83%	80%	85%
	% (mesatare)	44%	55%	62%	57%	51%
Të ardhura nga punësimi jashtë ferme	Pjesa e fermerëve që kanë të ardhura	43%	39%	41%	40%	34%
	% (mesatare)	33%	41%	37%	40%	44%
Pagesa nga shteti jo në formë page	Pjesa e fermerëve që kanë të ardhura	43%	59%	17%	46%	58%
	% (mesatare)	20%	30%	0%	26%	28%
Dërgesa nga emigracioni	Pjesa e fermerëve që kanë të ardhura	0%	20%	7%	15%	29%
	% (mesatare)	:	43%	:	43%	51%
Totali i të ardhurave nga jashtë fermës	Pjesa e fermerëve që kanë të ardhura	57%	91%	59%	80%	84%
	% (mesatare)	22%	39%	29%	28%	34%

Shënim: Përqindjet nuk janë kulumative (100%) për zërat e të ardhurave duke qenë se përllogaritjet janë bërë me bazë mesatare; Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar.

Familjet e intervistuar në Kurbin deklarojnë se niveli minimal i shpenzimeve të nevojshme familjare në muaj është 49,200 lekë mesatarisht. Ndërsa aktualisht një familje shpenzon në muaj rreth 36,800 lekë të vjetra mesatarisht, pra me një diferencë prej (-12,400) lekë. Ndërkohë që rezultojnë se një familje në këtë zonë përfiton në muaj mesatarisht 41,807 lekë, ku rreth 12% të tyre kursejnë. Për secilën njësi më specifikisht shihni tabelën e mëposhtme (Tabela 26). Për shkak të numrit të ulët të familjeve aktuale në Laç vihen re edhe keqraportime, sidomos në shpenzimet mujore faktike të raportuara. Gjithsesi, vihet re që vlera e kursimeve mesatare për familje (rreth 5,000 lekë) është me pak se një e dyta e vlerës së klursimeve në nivel zone projekti.

Tabela 26: Shpenzimet, të ardhurat dhe kursimet familjare mujore në lekë në Kurbin

Treguesi (lekë të vjetra në muaj për familje)	Kurbin			Totali	Zona e projektit
	Laç	Mamurras	Milot		
Niveli minimal i shpenzimeve të nevojshme	47,685	46,336	55,205	49,200	44,935
Shpenzimet e realizuara aktuale	93,982	36,620	33,092	36,800	32,033
Diferenca mes shpenzimeve aktuale me ato të nevojshme	46,296	(9,715)	(22,114)	(12,400)	(12,902)
Të ardhurat mujore të deklaruara	73,920	40,555	41,918	41,808	45,306
Kursimet mujore të deklaruara	(20,062)	3,935	8,826	5,008	13,272

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

Punësimi kryesor

Aktiviteti kryesor ekonomik për popullsinë që i korrespondon familjeve të intervistuar në Kurbin është punësimi në fermën e vet (37.5% e antarëve të familjes në moshë pune), ndërsa punësimi jashtë fermës në sektorin publik dhe privat kontribuon me 13.7% të forcës së aftë puntore (8.9% në sektorin privat dhe 4.8% në sektorin publik. Një numër i konsiderueshëm (28 vetë ose 6.4%) deklarohet se ka emigruar mbi tre muaj brenda vitit të fundit, dhe gati 1 në katër të intervistuar (23.4% % e forcës së aftë për punë) deklarohet si i papunë. Kurbin karakterizohet nga nivel mesatar punësimi në bujqësi dhe nivel krahasimisht më lartë papunësie krahasuar me zonën e projektit; kjo vjen kryesisht nga niveli i lartë i papunësisë në Mamurras (dy njësitë e tjera kanë nivel më të ulët papunësie krahasuar me zonën e projektit), Tabela 27.

Tabela 27: Aktiviteti kryesor për antarët e familjes në moshë pune

Treguesit e aktivitetit kryesor	Kurbin				Zona e projektit
	Njësia Administrative				
	Laç	Mamurras	Milot	Totali	

	Numër	%	Numër	%	Numër	%	Numër	%	Numër	%
Punon vetëm në fermën e vet	15	48.4%	106	36.3%	44	37.6%	165	37.5%	628	37.9%
Punësuar në sektorin privat	2	6.5%	27	9.2%	10	8.5%	39	8.9%	108	6.5%
Punësuar në sektorin publik	3	9.7%	10	3.4%	8	6.8%	21	4.8%	70	4.2%
Pa punë	5	16.1%	82	28.1%	16	13.7%	103	23.4%	336	20.3%
Nxënës/Student	3	9.7%	15	5.1%	18	15.4%	36	8.2%	174	10.5%
Emigracion (mbi 3 muaj)	0	0.0%	20	6.8%	8	6.8%	28	6.4%	153	9.2%
Në pension	3	9.7%	32	11.0%	13	11.1%	48	10.9%	187	11.3%
Total	31	100.0%	292	100.0%	117	100.0%	440	100.0%	1656	100.0%

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vërtetimit të strukturuar

Emigrimi

Sipas deklaramit të fermerëve (vërtetimi i strukturuar), emigrimi në Kurbin është i kufizuar – vetëm 28 familje deklarohen të kenë antarë të familjes në emigracion. Veçoria e emigracionit në Kurbin është se gati gjysma e emigrantëve me kohë qëndrimi më shumë se një vit (13 nga 28 të emigruarit konsiderohen me më shumë se një vit). Ky është një rezultat i ndryshëm nga rezultati i zonës së projektit ku dominon emigrimi sezonal (Tabela 28). Arsytet e emigrimit janë tërësisht ekonomike - 100% e atyre që kanë emigruar e kanë bërë këtë për arsye ekonomike.

Tabela 28: Emigrimi në Kurbin dhe zonën e projektit

	Kurbin						Zona e projektit	
	Njësia Administrative				Total			
	Mamurras		Milot		Numër	%	Numër	%
	Numër	%	Numër	%				
Emigrim më shumë se një vit	9	45.0%	4	50.0%	13	46.4%	29	19.0%
Emigrim sezonal	11	55.0%	4	50.0%	15	53.6%	124	81.0%
Total	20	100.0%	8	100.0%	28	100.0%	153	100.0%

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vërtetimit të strukturuar

Pjesëmarrësit në grupin e fokusuar vlerësojnë ndërkaq që numri i familjeve me emigrantë në zonë është shumë më i madh dhe mund të arrijë në gati 80% të familjeve. Kjo sepse ata që përftojnë nga ndihma e WV janë më të prirur të mos kenë ndihmesë nga emigrimi. Janë kryesisht emigrantë ekonomikë afatgjatë “që ikin për të mos u kthyer më”, që vazhdojnë të dërgojnë para familjeve të tyre të zgjeruara (extended families), “por më pak se më përpara”.

6. Potencialet e zhvillimit

Vlerësimi mbi potencialet e zhvillimit në bashkinë Kurbin

Perceptimet e fermerëve të intervistuar në Kurbin informojnë se 5 produktet potenciale më të rëndësishme janë gjedhi (31.1% e fermerëve fermerëve i konsiderojnë të imtat si aktivitetin më të rëndësishëm potencial), pemët frutore (pa arrorët) (26.4% e fermerëve), të imtat (20.8% e fermerëve), prodhimi i perimeve (5.7% e fermerëve), dhe prodhimi i arrorëve (3.8% e fermerëve), **Tabela 29**. Gjedhi dhe arrorët duket se përfaqësojnë zgjedhjen e dytë dhe të tretë për fermerët. (Për më shumë detaje, referoju **Tabela 43**: Perceptimet e fermerëve mbi aktivitetin e dytë dhe të tretë potencial në Aneks)

Tabela 29: Perceptimet e fermerëve mbi produktin më të rëndësishëm potencial

Aktivitetet ekonomike	Kurbin		Zona e projektit	
	Numër	%	Numër	%
Gjedhi	33	31.1%	93	21.2%
Prodhimi i frutave (pa arrorët)	28	26.4%	77	17.5%
Të imtat	22	20.8%	115	26.2%
Prodhimi i perimeve	6	5.7%	31	7.1%
Prodhimi i arrorëve	4	3.8%	15	3.4%
Bletaria	3	2.8%	26	5.9%
Akuakultura	2	1.9%	5	1.1%
Prodhim vere në fermë	2	1.9%	6	1.4%
Përpunim fruta-perime në fermë	2	1.9%	7	1.6%
Derri	1	0.9%	2	0.5%
Tjetër	3	3%	62	14%
Total	106	100%	439	100%

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

Pjesëmarrësit në grupin e fokusuar konfirmojnë produktet e vlerësuara si më të rëndësishmet nga fermerët (**Tabela 29**) por konsiderojnë frutat (vreshta, ullinj, arrorë) si prioritet për bashkinë Kurbin. Megjithatë gjedhi dhe të imtat janë aktivitete tradicionale dhe të rëndësishme për vetë-mbajtjen (ushqimin e familjes), ato janë në stanjacion ose në rënie – çmimi qumështit të lopës është shumë i ulët (deri në 38 lekë për litër). Përveç shitjes direkte, tregu i qumështit me destinacion përpunimin përfaqësohet nga 3 grumbullues dhe 4 përpunues qumështi (blerës afër fermerëve). Frutat, kryesisht vreshtat dhe ulliri, janë një prioritet për bashkinë Kurbin. Fermerët po shtojnë prodhimin e rrushit Çelek (vajguri ose rrushi i zi me erë), i cili përpunohet në raki dhe verë. Të dy këta produkte konsumohen nga vetë fermerët por edhe shiten. Në Kurbin ka tre kantina vere që prodhojnë vetë rrushin e tyre por edhe blejnë rrush nga fermerët - kryesisht jashtë bashkisë. Në Kurbin ka rreth 12,000 rrënjë ullinj shekullorë të cilët janë tërësisht të pa mirëmbajtur. Nxitur nga skemat e mbështetjes së qeverisë, në Kurbin janë mbjellë edhe rishtaz mbi 100 ha ullinj. Industria e përpunimit të vajit përfaqësohet nga 2-3 fabrika vaj ulliri me teknologji të vjetër, gjë që i shtyn fermerët ta shesin prodhimin e tyre jashtë Kurbin. Një numër fermerësh kultivojnë arrorë, kryesisht lajthi dhe arra. Në Kurbin ka edhe një bllok gështenjash spontane të trashëguara (5,000 rrënjë), ndarë “fshatçe” sipas kufinjve të vjetër. Kultivimi i bimëve aromatike-mjekësore nuk shihet si një aktivitet potencial për Kurbinin. Bimët aromatike-mjekësore kultivohen kryesisht në toka skeletike jo të përshtashme për bimë të tjera. “*Ka pak kultivim – Rozmarina ka pas qenë kultivuar në një farë mase por ka dështuar. Pra kryesisht grumbullohen bimë të egra, kryesisht sherebela.*” (Burimi: Grupi i fokusuar).

Sipas vlerësimit të përfaqësuesve të njësive bashkiake, gjedhi, të imtat dhe prodhimi organik përfaqësojnë aktivitetet ekonomike më të rëndësishme, të imtat (të dhirtat) dhe përpunimi i qumështit në fermë përfaqësojnë aktivitetin ekonomik të dytë më të rëndësishëm dhe perimet, derri dhe bleta përfaqësojnë produktin e tretë më të rëndësishëm.

Si konkluzion i vlerësimit nga fermerët (intervista e strukturuar), pjesëmarrësit në grupet e fokusuar dhe përfaqësuesit e njësive bashkiake, rezulton se dy aktivitetet më të rëndësishme janë ato të prodhimit

blegtoral, konkretisht mbarështimi i gjedhit dhe të imtave (konsensus nga tre burime). Prodhimi frutave (vreshta, ullinj, arrorë) duket se vlerësohet si potencial i rëndësishëm nga ekspertët në grupin e fokusuar. Diversiteti i kushteve sipas zonave sugjeron edhe konsiderimin me kujdes të disa aktiviteteve specifike si turizmi në fermë dhe agroturizmi (Burimi: grupi i fokusuar), prodhimi organik, përpunimi në fermë, mbarështimi i derrit dhe i bletës (Burimi: vrojtim me përfaqësor të njësive bashkiake).

7. Kapacitetet njerëzore dhe nevoja për rritjen e tyre


7.1 Vlerësimi i nevojave për rritje kapacitetesh dhe metoda e preferuar

Në këtë seksion jepet informacion i përmbledhur mbi nevojat prioritare për rritje kapacitetesh për produktet me potenciale zhvillimi, si dhe diskutohet mbi metodat e preferuara nga fermerët për rritjen e kapaciteteve.

7.1. Vlerësimi i nevojave prioritare për rritje kapacitetesh

Perceptimi i fermerëve të intervistuar në bashkinë Kurbin për nevojën prioritare për rritje kapacitetesh për produktin më të rëndësishëm potencial vizualizohet në Figura 11 (referoju Tabela 29 për produktin më të rëndësishëm potencial).

Figura 11: Nevoja prioritare për rritjen e kapaciteteve për për produktin prioritar



Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimin të strukturuar

Pesë nevojat prioritare për rritje kapacitetesh për produktin e konsideruar si produktin me potencial më të madh zhvillimi janë (i) këshillimi për perzgjedhjen e kultivarëve dhe racave të blegtorisë (59.4% e fermerëve e konsiderojnë këtë si nevojën e parë), (ii) këshillimi mbi të ushqyerit e bimëve e kafshëve (13.2% e fermerëve), (iii) këshillimi mbi mbrojtjen e bimëve dhe kafshëve (17% e fermerëve), (iv) këshillimi për përgatitjen e planeve të biznesit (dhe përgatitjen e aplikimeve) (3.8% e fermerëve), dhe (v) informacion mbi tregjet e produkteve (1.9% e fermerëve); një në 10 fermerë (10.4%) konsiderojnë informacionin mbi tregjet si nevojën më prioritare për produktin e dytë prioritar. Nevoja e mësipërme prioritare për rritje kapacitetesh bëhet më e qartë nga vlerësimet për nevojën e parë prioritare për produktin e dytë prioritar (për më shumë detaje, referoju Figura 24 në Aneks).

Pjesëmarrësit në grupin e fokusuar konfirmojnë nevojat prioritare për rritjen e kapaciteteve. Zgjedhja e species dhe kultivarit ose përshtatja e bimës më tokën dhe klimën konsiderohet si një nevojë e rëndësishme. *“Ka pasur mbjellje varietetesh ulliri që nuk përshtaten me tokën dhe klimën. Fermerët nuk bëjnë asnjëherë analiza toke kur bëjnë mbjellje ulliri apo vreshta. Në aplikimet për subvencione, kanë bërë mbjellje vend e pa vend. Ka të ardhur nga zona të tjera malore që kanë mbjellë ullinj me dhjetra hektar në fushë.”* (Burimi: Grupi i fokusuar). Megjithëse fermerët pretendojnë se kanë njohuri mbi teknologjinë e prodhimit të frutave, ekspertët vlerësojnë se ka nevojë për trajnimin e tyre lidhur me mbrojtjen dhe të ushqyerit e bimëve. *“Ka një mentalitet (pjesa e veriut të vendit) për të thënë që i dinë gjërat edhe kur nuk i dinë. Në Lushnje dhe Berat, fermerët kanë mentalitet tjetër. Nëse ka nevojë për mbrojtjen e bimëve – doktor bimësh, fermerët e kërkojnë atë”*. Mbrojtja e bimëve bëhet më e nevojshme në kushtet e ndryshimeve klimatike. Për shembull, temperaturat e larta dhe lagështia që ka shoqëruar muajin qershor ka krijuar probleme me hirin e hardhisë, të cilin fermerët e kanë të vështirë ta luftojnë. Në këtë kontekst është i rëndësishëm këshillimi mbi preparatin efikas dhe kohën e aplikimit të tij në bimë. Krijimi i shërbimit të prognozë-sinjalizimit do të ishte një investim i nevojshëm. Ekspertët vlerësojnë si të nevojshëm edhe këshillimin mbi të ushqyerit e bimëve (e lidhur me analizat e tokës). Lidhur me asistencën për skemat e mbështetjes, vlerësohet se më efikase është mbështetja për skemën e qeverisë më shumë se për IPARD. *“Për sa i përket IPARD, kërkesa për para-financim të investimit i përjashton fermerët nga përdorimi i kësaj mënyre financimi”*.

Sipas vlerësimit të përfaqësuesve të njësive bashkiake, nevojat më prioritare për aktivitetin më të rëndësishëm janë këshillim për zgjedhjen e kultivarëve (Milot), këshillim për mbrojtjen e bimëve (Laç) dhe këshillim për kooperimin (Mamurras). Nevojat e dyta prioritare për produktin prioritar janë këshillim për plane biznesi mbi mbështetjen qeveritare (Mamurras e Milot) dhe këshillim për llogaritjen e kostos (Laç). Ndërsa nevojat e treta prioritare për produktin prioritar janë përmirësimi i kapaciteteve të përpunimit, shërbimet e certifikimit dhe informacion mbi tregjet e prodhimit.

Si konkluzion i vlerësimit nga fermerët (intervista e strukturuar), pjesëmarrësit në grupet e fokusuar dhe përfaqësuesit e njësive bashkiake, rezultojnë se tre nevojat prioritare për të cilat ka konsensus janë këshillimi mbi specien dhe kultivarin, këshillimi mbi mbrojtjen e bimëve dhe asistencë për përfitimin nga skemat e qeverisë. Këshillimi mbi të ushqyerit e bimëve vlerësohet i nevojshëm nga fermerët dhe ekspertët bashkë. Ndërkaq, përfaqësuesit e njësive bashkiake përmendin edhe një sërë nevojash specifike të tilla si këshillim për kooperimin mes fermerëve, edukimin financiar, përmirësimin e njohurive mbi përpunimin në fermë, shërbimet e certifikimit dhe informacion mbi tregjet e prodhimit.

7.2. Metoda e preferuar e rritjes së kapaciteteve

Metoda më e preferuar nga fermerët e intervistuar të Kurbinit është praktikë në terren, klasë e terren dhe udhëtimet studimore; pothuaj 1 në 3 fermerë të intervistuar në Kurbin (29% e fermerëve) preferojnë praktikën në terren, ndërsa 1 në 4 fermerë kombinimin e klasës me terrenin. Duket qartë se fermerët në Kurbin kërkojnë njohuri praktike të transmetuara në terren. Udhëtimet studimore janë gjithashtu një metodë e preferuar e rritjes së kapaciteteve.

Tabela 30. Metoda e preferuar e rritjes së kapaciteteve

Metoda e rritjes së kapaciteteve	Kurbin		Zona e projektit	
	Numër	%	Numër	%
Trajnim në klasë	81	13%	398	12.7%
Praktikë në terren	218	29%	676	23.9%
Klasë dhe terren	157	24%	743	24.9%
Ndihmë individuale ose në grup (Coaching)	93	16%	644	24.4%
Udhëtime studimore	151	18%	415	14.1%
Raste të vlefshme/Përqindje	700	100%	2876	100%
Numri i mundshëm i përgjigjeve (106*11)	1166		4829	

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

Nga diskutimet në grupin e fokusuar, del se udhëtimet studimore (të shkëmbimit të eksperiencës) brenda vendit për të mësuar “praktikat më të mira” të teknologjisë, mund të ishte një metodë shumë efektive për ndryshimin e mentalitetit mbi teknologjinë.

Praktika të testuara të mbështetjes me asete fizike në natyrë të familjeve më në nevojë mund të jenë qasje efektive për rritjen e kapaciteteve. Rasti i mbështetjes së fermerëve të Fushë-Kuqes nga Kisha ofron një shembull se si mund të kombinohet mbështetja e financiare (në natyrë) në shkallë të vogël me këshillimin.

Kutia 1: Mbështetje me investime në sera për fermerët e Fushë-Kuqes, Laç

Një nga programet e mbështetjes së Kishës së Fushë-Kuqes në Laç ka qenë edhe mbështetje me investime të vogla fizike të fermerëve, me kushtin që (i) ata të ishin fermerë në nevojë dhe (ii) të ishin të besueshëm, (iii) të kontribuonin me 10% të ardhurave të tyre për kishën dhe (iv) të ishin aktivë në krijimin e një platforme bashkëpunimi mes tyre. Investimi u krye nga një kompani që u angazhua nga kisha dhe aseti ju fal fermerit duke nënshkruar një marrëveshje me kushtet e mësipërme.

Janë 11 fermerë të mbështetur nga kisha që prej tre vitesh dhe që të gjithë vazhdojnë punojnë në serën e tyre. Disa kanë rezultate më të mira, të tjerë kanë rezultate më modeste. Por të gjithë punojnë në serën e tyre dhe fitojnë të ardhura për familjet e tyre.

Duhet përmendur se fermerët nuk dhanë 10%-shin e përcaktuar në kontratë për Kishën si dhe nuk u treguan të gatshëm për bashkëpunim mes vedit dhe me Kishën. Por, konsideruar në këndvështrim pozitiv ata janë të gjithë duke fituar të ardhura për familjet e tyre duke përdorur serën e dhuruar.

Programi përfshinte edhe mbështetje me bagëti (lopë) me kushtin që fermeri ta mbante për vehte viçin nëse do ishte femër por t’ja falte kishës nëse viçi ishte mashkull. Një veteriner i paguar me 300 Euro në muaj ofronte shërbimin e shëndetit të kafshëve për fermerët e mbështetur.

Burimi: Intervista me Padre Matij, Kisha e Fushë-Kuqes Laç

8. Ofruesi i këshillimit dhe informacionit, cilësia dhe qasja e shërbimit

8.1. Vlerësimi mbi ofruesin e këshillimit dhe informacionit, cilësinë dhe lehtësinë e qasjes

Ofruesi i këshillimit dhe informacionit

Ofruesi kryesor i këshillimit për fermerët e intervistuar në bashkinë Kurbin është konsulenti privat (vlerësuar si i tillë nga 48% e fermerëve), e ndjekur nga Drejtoria e bujqësisë (21% e fermerëve) dhe qeveria lokale (15% e fermerëve), [Tabela 31](#). Tregtarët e inuteve përmenden gjithashtu si ofrues shërbimesh. Dallimi kryesor mes Kurbin dhe zonës së projektit për sa i përket ofruesit kryesor të shërbimit është prania e konsulentit privat.

Tabela 31: Ofruesi i këshillimit dhe informacionit

Ofruesit e shërbimit të këshillimit dhe informacionit		Zona e Programit			
		Kurbin		Total	
		Numër	%	Numër	%
Këshillim	Drejtoria e bujqësisë	152	21%	610	20%
	Qeveria lokale	106	15%	444	15%
	Universiteti	1	0%	97	3%
	Tregtari i inuteve	64	9%	360	12%
	Blerësi i produktit	41	6%	448	15%
	Konsulent privat	350	48%	503	16%
	Konsulencë projektsh	9	1%	599	20%
	Totali	723		3061	
Numri i mundshëm i përgjigjeve (106, 439*9)		963	954		3951
Informacion	Drejtoria e bujqësisë	29	13%	149	14%
	Qeveria lokale	57	19%	173	13%
	Universiteti	0	0%	45	6%
	Tregtari i inuteve	8	3%	119	12%
	Blerësi i produktit	10	3%	207	21%
	Konsulent privat	120	63%	176	17%
	Konsulencë projektsh	6	2%	178	16%
	Totali	230	100%	1047	100%
Numri i mundshëm i përgjigjeve (106, 439*4)		428	424		1756

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

Nga të dhënat e tabelës më sipër, bëhet e qartë se ofruesi kryesor i informacionit është gjithashtu konsulenti privat (63% e fermerëve), ndjekur nga qeveria lokale (19% e të intervistuarve), dhe Drejtoria e Bujqësisë (13% e fermerëve). Ashtu si edhe për këshillimin, duket se fenomeni i konsulentit privat është i pranishëm edhe në ofrimin e informacionit.

Pjesëmarrësit në grupin e fokusuar konfirmojnë se ofruesit kryesorë të shërbimit të këshillimit dhe informacionit janë tregtarët e inuteve dhe Drejtoria e Bujqësisë. Nga diskutimi në grupin e fokusuar del se me konsulent privat konsiderohet tregtari i inuteve – tregtarët e medikamenteve të mbrojtjes së bimëve dhe plehrave kimike (Farmacitë bujqësore). “*Ka rreth 7-8 farmaci bujqësore që ofrojnë edhe trajnim*” (Burimi: Grupi i fokusuar). Klinikat veterinarë gjithashtu ofrojnë këshillim për fermerët. “*Në Kurbin kemi tri klinika veterinarë një në Mamurras dhe dy në Laç*”. (Burimi: Grupi i fokusuar). Blerësit e produktit nuk janë një aktor i rëndësishëm i ofrimit të këshillimit dhe informacionit. Tri kantinat (kur blejnë rrush) e blejnë atë jashtë bashkisë. Fenomeni i këshillimit të fermerit nga blerësi i produktit është shumë i kufizuar. “*Është një kantinë e vogël që blen nga disa fermerë dhe asiston fermerat*”.

Cilësia në këshillim

Vlerësimi për cilësinë e këshillimit është përgjithësisht e keqe deri në mesatare – pothuaj gjysma e fermerëve (46%) vlerëson se cilësia e këshillimit është shumë e keqe dhe e keqe dhe rreth 1 në 3 fermerë (36%) vlerëson se cilësia e këshillimit është mesatare, [Tabela 32](#).

Tabela 32: Cilësia e këshillimit

Vlerësimi për cilësinë e shërbimit të këshillimit	Kurbini		Total	
	Numër	%	Numër	%
Shumë e keqe	92	9%	378	9%
E keqe	374	37%	1151	27%
Mesatare	359	36%	1789	42%
E mirë	155	16%	747	18%
Shumë e mirë	19	2%	179	4%
Totali	999	100%	4244	100%
Numri i mundshëm i përgjigjeve (106, 439*13)	1378		5707	

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

Qasja në këshillim dhe informacion

Pothuaj 2 në 3 fermerë (66%) raportojnë të kenë një qasje të vështirë e shumë të vështirë në këshillim, - një shifër më e lartë se vlerësimi për zonën e projektit, ndërsa 3 në 4 fermerë (76%) vlerëson se qasja në informacion është e vështirë dhe shumë e vështirë [Tabela 33](#).

Tabela 33: Qasja në këshillim dhe informacion

Vlerësimi që lehtësinë e qasjes në shërbimin e këshillimit dhe informacionit		Zona e Programit			
		Kurbini		Total	
		Numer	%	Numer	%
Këshillim	Qasje shumë e vështirë	123	16%	625	19%
	Qasje e vështirë	384	50%	1266	39%
	Qasje mesatare	172	22%	995	31%
	Qasje e lehtë	85	11%	295	9%
	Qasje shumë e lehtë	7	1%	64	2%
	Total	771	100%	3245	100%
Numri i mundshëm i përgjigjeve (106, 439*9)			954		3951
Informacion	Qasje shumë e vështirë	52	20%	257	23%
	Qasje e vështirë	144	56%	475	42%
	Qasje mesatare	53	21%	266	24%
	Qasje e lehtë	9	3%	99	9%
	Qasje shumë e lehtë	0	0%	34	3%
	Total	258	100%	1131	100%
Numri i mundshëm i përgjigjeve (106, 439*4)			424		1756

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

8.2. Situata dhe mënyra e komunikimit

Mjedisi i komunikimit

Vendi i zakonshëm për diskutimet lidhur me teknologjinë e prodhimit (dhe eventualisht edhe për çështje të tjera) është qendra e fshtatit ose lagja – pothuaj të gjithë fermerët e intervistuar (98.1% e të intervistuarve) konsiderojnë lagjen si vendin e zakonshëm për diskutime teknike dhe pothuaj 9 në 10 të intervistuar (87.7% e të intervistuarve) konsiderojnë fshatin si vendin e diskutimeve teknike. Kjo tendence konfirmohet edhe në nivelin e zonës së projektit. Njësia administrative dhe bashkia duket se janë me distancë për fermerët në pikëpamje të diskutimeve teknike, [Tabela 34](#).

Tabela 34: Mjedisi ku komunikohet për teknologjinë e prodhimit

Mjedisi i komunikimit për teknologjinë		Zona e Programit			
		Kurbini		Zona e projektit	
		numër	%	numër	%
Diskutimi për teknologjinë bëhet në bashki	Jo	72	81.8%	323	79.4%
	Po	16	18.2%	84	20.6%
	total	88	100.0%	407	100.0%
Diskutimi për teknologjinë bëhet në njësinë administrative	Jo	75	86.2%	244	59.2%
	Po	12	13.8%	168	40.8%
	total	87	100.0%	412	100.0%
Diskutimi për teknologjinë bëhet me njëri-tjetrin në qendrën e fshatit	Jo	13	12.3%	52	12.0%
	Po	93	87.7%	382	88.0%
	total	106	100.0%	434	100.0%
Diskutimi për teknologjinë bëhet me njëri-tjetrin në lagje	Jo	2	1.9%	23	5.3%
	Po	103	98.1%	410	94.7%
	total	105	100.0%	433	100.0%

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vërtetimit të strukturuar

Pandemia dhe komunikimi

Duket se pandemia ka patur një ndikim të rëndësishëm në intensitetin e komunikimit. Më shumë se 2 në 3 fermerë (ose 68%) shprehet se pandemia ka penguar komunikimin. Pandemia ka prekur lëvizshmërinë në Kurbini pak më shumë se në gjithë zonën e projektit (Tabela 35).

Tabela 35: Ndikimi i pandemisë në intensitetin e komunikimit

Ndikimi i pandemisë në levishmëri dhe komunikim		Kurbini		Total	
		numër	%	numër	%
A ju ka penguar pandemia në vajtjen në: Bashki	Jo	26	30.2%	103	25.0%
	Po	60	69.8%	309	75.0%
	total	86	100.0%	412	100.0%
A ju ka penguar pandemia në vajtjen: Në njësinë administrative	Jo	28	32.6%	117	28.1%
	Po	58	67.4%	299	71.9%
	total	86	100.0%	416	100.0%
A ju ka penguar pandemia në vajtjen në: kafene/qendër fshati	Jo	25	23.8%	169	38.9%
	Po	80	76.2%	265	61.1%
	total	105	100.0%	434	100.0%
A ju ka penguar pandemia në vajtjen në: Me njëri tjetrin në shtëpi në lagje	Jo	45	42.9%	251	58.1%
	Po	60	57.1%	181	41.9%
	total	105	100.0%	432	100.0%
Total	Jo	124	32%	640	38%
	Po	258	68%	1054	62%
	total	382	100%	1694	100%
Numri i mundshëm i përgjigjeve (106, 439*4)		424		1756	

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vërtetimit të strukturuar

Interneti si mënyrë komunikimi

Interneti është mënyrë e rëndësishme e komunikimit të fermerëve me specialistët për marrjen e informacionit lidhur me teknologjinë dhe tregjet: pothuaj 4 në çdo 10 fermerë (43%) të Kurbinit përdorin internetin për zgjidhjen e problematikave të fermës. Nga të dhënat duket interneti përdoret më shumë për aspekte të këshillimit mbi teknologjinë e prodhimit dhe marrjen e informacionit lidhur me inputet (Tabela 36).

Tabela 36: Interneti si mënyrë komunikimi për informacion mbi teknologjinë e tregjet

Çështjet		Kurbin		Total	
		numër	%	numër	%
Përdorimi i internetit për informacion për teknologji prodhimi dhe shëndetit të bimeve ose kafshëve	Jo	56	52.8%	229	52.6%
	Po	50	47.2%	206	47.4%
	total	106	100.0%	435	100.0%
A e përdor internetin për të grumbulluar informacion për çmimet dhe informacion për tregun	Jo	62	59.0%	277	63.8%
	Po	43	41.0%	157	36.2%
	total	105	100.0%	434	100.0%
A e përdor internetin për të marrë informacion për inputet dhe pajisjet	Jo	57	54.3%	281	64.6%
	Po	48	45.7%	154	35.4%
	total	105	100.0%	435	100.0%
A e përdor internetin për të komunikuar për problemet e fermës tuaj me specialistë ose të tjerë	Jo	63	60.0%	271	62.6%
	Po	42	40.0%	162	37.4%
	total	105	100.0%	433	100.0%
Total	Jo	238	57%	1058	61%
	Po	183	43%	679	39%
	total	421	100%	1737	100%
Numri i mundësheë i përgjigjeve (106, 439*4)		424		1756	

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vërtetimit të strukturuar

9. Partnerët e zhvillimit për ofrimin e shërbimeve të këshillimit dhe informacionit

9.1. Partnerët e zhvillimit

Pesë parterët më të rëndësishëm të zhvillimit në Kurbin (renditur sipas numrit të përgjigjeve pozitive) janë drejtoria e bujqësisë (25.5% e të intervistuarve), njësia bashkiake (19.8%), tregtarët e inputeve (18.9%), AZHBR (16%) dhe blerësit e produkteve (11.3%). Listohet edhe një “partner tjetër” kryesisht WV, (Tabela 37).

Tabela 37: Partnerët e zhvillimit në Kurbin dhe zonën e projektit

Partneri	Kurbin		Zona e projektit	
	Numër	%	Numër	%
Drejtoria e Bujqësisë	27	25.5%	140	32.1%
Njësia bashkiake	21	19.8%	200	45.9%
Tregtarë inputesh	20	18.9%	131	30.0%
AZHBR	17	16.0%	50	11.5%
Blerësit e produkteve	12	11.3%	169	38.8%
Agjenci Zhvillimi	2	1.9%	10	2.3%
Universiteti	2	1.9%	2	0.5%
Tjetër (WV)	38	35.8%	116	26.6%

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtitimit të strukturuar

Zëri tjetër i korrespondon kryesisht WV, si për Kurbinin ashtu edhe për zonën e projektit.

9.2. Kapaciteti i partnerëve

Kapaciteti patnerëve kryesorë për ofrimin e shërbimeve të këshillimit dhe informacionit është i ulët – më shumë se 6 në 10 fermerë të intervistuar (65% e fermerëve) vlerësojnë se kapacitetet e partnerëve janë të ulta dhe shumë të ulta dhe vetëm 6% e tyre vlerësojnë se kapacitete janë të larta e shumë të larta. Vlerësimet dukshëm më të ulta se për zonën e gjithë projektit (Tabela 38).

Tabela 38: Perceptimi mbi kapacitetet e partnerëve për ofrimin e këshillimit dhe informacionit

Kapacitetet e partnerëve	Kurbin		Zona e projektit	
	Numër	%	Numër	%
Shumë të ulta	268	37%	937	33%
Të ulta	204	28%	637	22%
As të ulta, as të larta	216	29%	838	29%
Të larta	45	6%	367	13%
Shumë të larta	0	0%	89	3%
Total	733	100%	2868	100%
Numri i mundshëm i përgjigjeve (106, 439*8)	848		3512	
Të ulta e shumë të ulta	472	65%	1574	54.9%
Të larta e shume të larta	45	6%	456	15.9%

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtitimit të strukturuar

Fermerët e Kurbinin kanë një vlerësim negativ pothuaj horizontal lidhur me kapacitetet e ofruesve të shërbimit dhe informacioni. Megjithëse për universitetin ka një vlerësim paksa më pozitiv (11% e fermerëve i konsiderojnë kapacitetet e universitetit si të larta e shumë të larta), universiteti nuk duket të jetë partner i rëndësishëm në Kurbin.

10. Efektet e pandemisë Covid-19 mbi funksionimin e zinxhirëve të vlerës dhe sigurinë ushqimore

10.1. Efektet e pandemisë Covid-19 mbi funksionimin e zinxhirëve të vlerës

Ashtu sikurse u tregua edhe në seksionin 5, pjesa më e madhe e prodhimit blegtoral (mbi 70%) dhe një pjesë e prodhimit bujqësor (nën 25%) janë të destinuara për treg. Duke qenë se vetëm rreth 20% e fermerëve u janë përgjigjur pyetjeve për mundësinë e të punuarit përgjatë periudhës kulmore të pandemisë dhe duke qenë se pjesa më e madhe e tyre kanë ndjekur punët, sidomos në mbjellje foragjeresh dhe punë toke, vërejmë se problemi më i zakonshëm i hasur për ato pak persona që kanë deklaruar pengesa (64 persona në të gjithë zonën e projekti) është pamundësia për të blerë mekanikë, farë apo plehra për mbjellje. Nga takimet në grupe të fokusuara dhe në intervista, përtej problemeve të hasura në ditët e para, nuk ka patur pengesa të aksesit të fermerëve me kalimin në ngastra apo kullota. Ka patur mungesë të dërgesës së produkteve bulmetore në treg, çka nga eksperiencia e gjatë e fermerëve është vetëkorrigjuar nëpërmjet përpunimit. Në disa fshatra u vu re një rritje e vëmendjes drejt punëve të bujqësisë, si pasojë edhe e izolimit nga lëvizjet drejt emigrimit sezonal.

10.2. Efekti i pandemisë tek të ardhurat mujore familjare

Fermerët u pyetën nëse të ardhurat e tyre kanë pësuar ulje për shkak të pandemisë (për secilën kategori të të ardhurave). Tabela dhe figurat pasardhëse paraqesin rezultatet përshkruese sipas njësive administrative dhe në total për bashkinë Kurbin. Shumica e atyre që përmendin pandeminë si faktor për uljen e të ardhurave, tregojnë se kanë pësuar ulje në krahasim më të njëjtën periudhë të vitit të kaluar në të ardhurat mbledhura nga blegtoria dhe bujqësia (kryesisht në Mamurras), të ardhurat nga jashtë fermës (kryesisht Lac dhe Mamurras) dhe dërgesat nga emigracioni (kryesisht në Mamurras). Norma e përgjigjeve për këto pyetje ka qenë mdis 50%-60% përveç atyre pyetjeve që kanë të bëjnë me remitancat ku numri i atyre që përgjigjen është i ulët (Tabela 39). Ndryshe nga burimet e tjera të të ardhurave, transfertë pagesat si pensione, ndihmë ekonomike apo asistencë papunësie e të tjera si këto nuk kanë pësuar ndryshime të ndjeshme. Gjithashtu, rreth 50% e të intervistuarve që janë përgjigjur, pohojnë se kanë patur rënie të të ardhurave nga punësimi jashtë fermës për shkak të pandemisë.


Tabela 39: Ndryshimi i të ardhurave sipas kategorive për shkak të pandemisë për familjet në Kurbin

Njësi a Adm.	Ulja për shkak të pandemisë	Të ardhurat nga blegtoria	Të ardhurat nga bujqësia	Të ardhurat nga aktivitete grumbullimi	Të ardhura totale nga ferma	Të ardhura nga punësimi jashtë ferme	Pagesa nga shteti jo në formë page	Dërgesa nga emigracioni	Totali i të ardhurave nga jashtë fermës
Laç	Jo	100%	60%	0%	100%	50%	100%	0%	67%
	Po	0%	40%	0%	0%	50%	0%	0%	33%
	%*	71%	71%	0%	29%	29%	29%	0%	43%
Mamurras	Jo	24%	29%	33%	42%	39%	80%	26%	50%
	Po	76%	71%	67%	58%	61%	20%	74%	50%
	%*	54%	54%	4%	37%	40%	50%	27%	54%
Milot	Jo	81%	86%	100%	73%	67%	100%	57%	70%
	Po	19%	14%	0%	27%	33%	0%	43%	30%
	%*	72%	72%	3%	52%	41%	38%	24%	34%
Kurbin	Jo	48%	50%	50%	56%	48%	85%	35%	55%
	Po	52%	50%	50%	44%	52%	15%	65%	45%
	%*	60%	60%	4%	41%	40%	45%	25%	48%

Shënim: %* e observimeve të vlefshme; Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

Për të parë situatën e të ardhurave në nivel bashkie shikoni grafikët ilustrues të mëposhtëm. Rezultatet e analizës përshkruese tregojnë se dhe në nivel bashkie të ardhurat që kanë pësuar ulje prej pandemisë për shumicën e familjeve janë dërgesat nga emigracioni (Figura 12).


Figura 12: Përgjigjet e pyetjes “A kanë pësuar këto të ardhura ulje për shkak të pandemisë?” - Kurbin



Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

Në njësinë administrative Laç të ardhurat që kanë pësuar për shumicën ulje për shkak të pandemisë rezultojnë të jenë kryesisht të ardhurat nga punësimi jashtë fermës (50%) dhe të ardhurat nga bujqësia (40%) (Figura 13).


Figura 13: Përgjigjet e pyetjes “A kanë pësuar këto të ardhura ulje për shkak të pandemisë?” – Laç



Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

Për familjet e intervistuar në njësinë adm. Mamurras, për shkak të pandemisë të ardhurat që pësuan ulje sipas rëndësisë janë të ardhurat nga blegtoaria (76%), dërgesat nga emigracioni (74%), të ardhurat nga bujqësia (71%) etj. (për më shumë shiko Figura 14).


Figura 14: Përgjigjet e pyetjes “A kanë pësuar këto të ardhura ulje për shkak të pandemisë?” – Mamurras



Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vërtetimit të strukturuar

Për familjet e anketuara në njësinë adm. Milot të ardhurat që kanë pësuar më shumë ulje për shkak të pandemisë janë të ardhurat nga aktivitetet jashtë fermës (në total) por specifikuisht dërgesat nga emigracioni (43%) (Figura 15).

Figura 15: Përgjigjet e pyetjes “A kanë pësuar këto të ardhura ulje për shkak të pandemisë?” - Milot




Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vërtetimit të strukturuar

10.3. Efektet e pandemisë Covid-19 mbi sigurinë ushqimore të familjeve

Familjet e anketuara në Kurbin e kanë patur disi të vështirë konsumin e produkteve të listuara (shiko Figura 16 për produktet dhe përqindjet përkatëse) përgjatë muajve mars dhe prill. Për më tepër, 44% e të anketuarve deklarojnë se e kanë patur shumë të vështirë të konsumojnë grupmallrat në varësi të importit si makarona, oriz, sheqer apo vaj vegjetal përgjatë muajit mars-prill. Pamundësia e blerjes për këto produkte nis nga mungesat e përkohshme të lëvizjes dhe aksesit në të holla. Mungesa e qumështit dhe nënprodukteve të tij mund të jetë shkaktuar tek familje të cilat nuk kanë patur vetë prodhim. Në renditje shfaqet edhe mish, kryesisht për shkak të pamundësisë së thertoreve për tu furnizuar në ditët e para.


Figura 16: Shkalla e vështirësisë për konsumin e ushqimeve të mëposhtme përgjatë muajit mars-prill – Kurbin



Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

Familjet e anketuara në njësinë administrative Laç rezultojnë të mos kenë patur vështirësi në konsumin e ushqimeve si drithra, mish, qumësht apo vezë përgjatë muajit mars-prill. Më tej, 84% e familjeve e kanë patur shumë të vështirë aksesin në produkte si makaronat, orizi, sheqeri etj. dhe 33% e kanë patur të vështirë aksesin në konsumin e frutave (shiko Figura 17). Nga ana tjetër, 100% e të anketuarve deklarojnë se e kanë patur disi të vështirë aksesin në konsumin e perimeve.


Figura 17: Shkalla e vështirësisë për konsumin e ushqimeve të mëposhtme përgjatë muajit mars-prill – Laç



Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

Sipas rezultateve, shumica e familjeve të anketuara në Mamurras nuk e kanë patur aspak të vështirë konsumimin e ushqimeve si qumësht apo vezë (Figura 18) përgjatë muajit mars-prill. Më tej, 44% e familjeve në Mamurras e kanë patur shumë të vështirë aksesin në produktet e paketuara si makarona apo oriz.


Figura 18: Shkalla e vështirësisë për konsumin e ushqimeve të mëposhtme përgjatë muajit mars-prill – Mamurras



Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

Ndërsa në njësinë administrative Milot përveç rastit të produkteve të paketuara si makarona, oriz apo vaj e sheqer, shumica e familjeve nuk e kanë patur aspak të vështirë konsumin e ushqimeve si fruta, drithëra, mish, qumësht etj. përgjatë muajit mars-prill. Sipas rezultateve, 33% e familjeve e kanë patur shumë të vështirë konsumin e produkteve të paketuara (Figura 19).

Figura 19: Shkalla e vështirësisë për konsumin e ushqimeve të mëposhtme përgjatë muajit mars-prill – Milot



Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

Për të parë sa përqind të produkteve si fruta, perime, vezë apo mish vetëprodhojnë familjet në secilën njësi administrative por dhe në Kurbin total shikoni tabelën vijuese. Në Mamurras (90% e fermave) dhe Laç (70% e fermave) një pjesë e madhe e fermave tregojnë mundësi të vetëprodhimit e më pak në Milot (41% e fermave) (Tabela 40). Mundësia e vetëprodhimit shfaqet e lartë sidomos në vezë, produkte bulmeti e mish e më pak në fruta, perime e drithëra, kjo për shkak të sezonalitetit e tkurrjes së mundësisë për të blerë për shkak të mungesës së të hollave.


Tabela 40: Përgjigjet e pyetjes “Sa përqind të këtyre produkteve arrini ti prodhoni në fermën tuaj”

Produkti	Treguesi	Kurbini				Zona e programit
		Laç	Mamurras	Milot	Total	
	Totali i observimeve	7	70	29	106	439
Fruta	Pjesa e fermerëve që arrijnë të vetëprodhojnë	71%	90%	41%	74%	68%
	Mesatarja e vetëprodhimit të mundshëm (%)	58%	34%	82%	44%	39%
Perime	Pjesa e fermerëve që arrijnë të vetëprodhojnë	71%	94%	41%	74%	71%
	Mesatarja e vetëprodhimit të mundshëm (%)	47%	37%	77%	45%	40%
Drithëra	Pjesa e fermerëve që arrijnë të vetëprodhojnë	71%	90%	41%	74%	67%
	Mesatarja e vetëprodhimit të mundshëm (%)	92%	29%	42%	35%	42%
Mish	Pjesa e fermerëve që arrijnë të vetëprodhojnë	71%	96%	41%	74%	68%
	Mesatarja e vetëprodhimit të mundshëm (%)	83%	46%	62%	52%	39%
Qumësht e produkte bulmeti	Pjesa e fermerëve që arrijnë të vetëprodhojnë	71%	96%	41%	74%	75%
	Mesatarja e vetëprodhimit të mundshëm (%)	100%	76%	91%	81%	71%
Vezë	Pjesa e fermerëve që arrijnë të vetëprodhojnë	71%	96%	41%	74%	70%
	Mesatarja e vetëprodhimit të mundshëm (%)	100%	92%	100%	95%	72%

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

Në total, 66% e familjeve të anketuara në Kurbini kanë deklaruar se janë “pak të shqetësuar” nëse do të jenë në gjendje të sigurojnë për veten dhe familjen ushqim dhe artikujt bazë gjatë 2 muajve të ardhshëm (specifikisht sipas njësisve administrative: 71% në Laç, 72% në Mamurras dhe 52% në Milot). Ndërsa vetëm 15% e familjeve në bashkinë Kurbini (të anketuara) kanë deklaruar se janë “shumë të shqetësuar” nëse do të jenë në gjendje të sigurojnë ushqim dhe artikujt bazë për familjen gjatë 2 muajve të ardhshëm (0% në Laç, 15% në Mamurras dhe 21% në Milot) (Figura 20).


Figura 20: Rezultatet e pyetjes “Sa i/e shqetësuar jeni nëse do të jeni në gjendje apo jo të siguroni për veten dhe familjen tuaj ushqim dhe artikujt bazë gjatë 2 muajve të ardhshëm?”



Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

Figura 21 më poshtë paraqet rezultatet e pyetjeve mbi vlerësimin e pasigurisë së familjeve në Kurbini për të aksesuar produkte ushqimore. Në Kurbini 54% e familjeve kanë deklaruar se përgjatë dy muajve të pandemisë ishin të shqetësuar mbi sigurimin e ushqimit për familjen, rreth 40% tregonin se kishin hasur larmi të kufizuar e 27% tregonin se u ishte dashur të konsumonin produkte që nuk preferojnë. Përpjesa e atyre që pohojnë shkallë më të larta të pasigurisë ushqimore, pra që kanë eksperiencë të vakteve të mpakura apo të ushqyerjes me vakte të munguara gjatë ditës, vërtitej nën shifrë 10%.


Figura 21: Përgjigjet e pyetjeve për të vlerësuar pasigurinë e familjes për të aksesuar produkte ushqimore



Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar

Më tej Figura 22 na tregon se sa eksperiencia e pasigurisë së ushqimit për familjen janë shkaktuar nga pandemia. Mbi 65% e familjeve që pohuan shqetësime lidhur me aksesimin dhe sigurimin e ushqimit deklarojnë se këto shqetësime u shkaktuan nga pandemia. Me rëndësi mbetet fakti se pjesa e atyre që pohojnë ndikimin e pandemisë është shumë e lartë mes kategorisë së atyre fermerëve (megjithëse të pakët në numër) që vuajtën pasiguri të lartë ushqimore, pra që kanë eksperiencë të mungesës së vakteve në ditë.

Figura 22: Shqetësimet ndaj sigurimit të ushqimit të nevojshëm për familjen ndodhi prej pandemisë - Kurbin



Shënim: Përqindja e observimeve të vlefshme: 53% për pyetjen e parë, 38% për të dytën, 25% për të tretën, 9% për të katërtën dhe 8% për pyetjen e pestë; Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar.

Niveli i Pasigurisë (qasjes) Ushqimore ne Familje ofron informacion të përmbledhur mbi mundësinë që një familje të përjetojë një ose më shumë sjellje në secilën nga tre fushat e pasqyruara në HFIAS të cilat janë ankthi dhe pasiguria, cilësi e pamjaftueshme dhe sasi e pamjaftueshme ushqimore. Treguesi i HFIAS është në zonë është i kënaqshëm pra i ulët (Tabela 41). HFIAS ka një vlerë mesatare 2, e cila është më e kënaqshme së mesatarja e zonës së projektit dhe shumë larg nga vlera maksimale (15 e cila tregon nivel ekstrem të pasigurisë ushqimore në familje). Analiza të korrelacionit të kryera me të gjithë kampionin e vrojtimit treguan se niveli i pasigurisë ushqimore, është i lidhur në mënyrë statistikisht domethënëse me sipërfaqën e tokës së përdorur për frymë.


Tabela 41: Niveli i Pasigurisë (qasjes) Ushqimore ne Familje

Treguesi	Kurbin			Zona e projektit	
	Njësia administrative				Total
	Laç	Mamurras	Milot		
Observime në total	7	70	29	106	439
Niveli i HFIAS (mesatare)	2	3	2	2	4
Observime të vlefshme	100%	94%	93%	94%	99%

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vërtetimit të strukturuar

Prevalenca e Pasigurisë (qasjes) Ushqimore ne Familje (HFIAP) është një tjetër tregues që vlerëson ashpërsinë e mungesës së sigurisë ushqimore. Sipas rezultateve të analizës përshkruese, asnjë prej familjeve të anketuara në Kurbin nuk kanë një nivel të lartë të pasigurisë ushqimore (0% në secilën njësi administrative). Ndërsa 35% e familjeve kanë një nivel të konsiderueshëm të pasigurisë ushqimore (43% në Laç, 39% në Mamurras dhe 21% në Milot) (Figura 23).

Figura 23: Niveli i sigurisë ushqimore për familjet në bashkinë Kurbin dhe sipas njësive administrative



Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vërtetimit të strukturuar

11. Konkluzione dhe rekomandime

Konkluzione

Popullsia në familjet e intervistuar në bashkinë Kurbin (37.1 vjeç, 36.5 vjeç pa vlerat ekstreme) është e një moshe relativisht më të vjetër krahasuar me zonën e projektit; kjo i detyrohet kryesisht proporcionit më të ulët të fëmijëve dhe proporcionit të lartë të popullsisë në moshën e pensionit. Raporti i varësisë është më i lartë krahasuar me zonën e projektit por qartësisht më i ulët krahasuar me mesataren e vendit.

Rreth 4 mijë hektarë të Bashkisë Kurbin janë sipërfaqe toke e zonave të rëndësisë kombëtare dhe zonave të mbrojtura natyrore dhe kulturore. Kjo hapësirë, së bashku me hapësirën baferike të parqeve paraqesin burim të rëndësishëm për rajonin. Nisur nga këto kushte, të intervistuarit tregojnë se pesë burimet më të rëndësishme prodhuese në bashkinë Kurbin janë tokë bujqësore, kullotat dhe hapësirat pyjore, burimet ujore (liqeneve/rezervuarë, lumenjve dhe bregdet) dhe peizazhet natyrore. Sipërfaqja e tokës në pronësi është 13 dynym për familje (12 dynym pa vlerat ekstreme, dhe sipërfaqja e tokës së përdorur (si proksi për për madhësinë e fermës) është 19.8 dynym, 17.4 dynym pa vlerat ekstreme.

Qiramarrja shikohet si një rrugë e rritjes së përmasës së fermës në bashkinë e Kurbin - një numër i konsiderueshëm i familjeve të intervistuar në Kurbin marrin tokë me qira. Proporcioni i familjeve që marrin tokë me qira në Kurbin është qartësisht më i lartë se për zonën e projektit. Mesatarja e transaksionit të qiramarrjes është gjithashtu mjaft e lartë. Frekuenca e transaksioneve dhe përmasa e transaksioneve ka rezultuar në një përmasë të fermës dukshëm më madhe se sipërfaqja e tokës në pronësi për familje fermere. Duhet vërejtur ndërkaq, se fenomeni i marrjes së tokës me qira është më i dukshëm në njësinë bashkiake të Laçit.

Dy aktivitetet më të rëndësishme janë ato të prodhimit blegtoral, konkretisht mbarështimi i gjedhit dhe të imtave në zonat e larta të Kurbin (konsensus nga tre burime). Prodhimi frutave (vreshta, ullinj, arrorë) duket se vlerësohet si potencial i rëndësishëm nga ekspertët. Nga ana tjetër, diversiteti i kushteve sipas zonave sugjeron edhe konsiderimin me kujdes të disa aktiviteteve specifike si turizmi në fermë dhe agroturizmi, prodhimi organik, përpunimi në fermë, mbarështimi i dërrit dhe i bletës.

Tre nevojat prioritare për rritje kapacitetesh janë këshillim mbi specien dhe kultivarin, këshillim mbi mbrojtjen e bimëve, asistencë për përfitimin nga skemat e qeverisë (konsensus nga tre burime). Këshillimi mbi të ushqyerit e bimëve vlerësohet i nevojshëm nga fermerët dhe ekspertët. Ndërkaq, përfaqësuesit e njësive bashkiake përmendin edhe një sërë nevojash specifike si ndërhyrjet në kapacitete institucionale e infrastrukturore.

Pesë partnerët më të rëndësishëm të zhvillimit në Kurbin (renditur sipas numrit të përgjigjeve pozitive) janë drejtorja e bujqësisë, njësia bashkiake, tregtarët e inputeve, AZHBR dhe blerësit e produkteve. WV, listuar nën kategorinë “Të tjerë”) përmendet gjithashtu si partner i rëndësishëm.

Mjedise të preferuara komunikimi për fermerët janë mjediset më pranë fermerit, qendra e fshtatit ose lagjia. Njësia administrative dhe bashkia duket se janë më distante për fermerët e Kurbin në pikëpamje të diskutimeve teknike.

Interneti është mënyrë e rëndësishme e komunikimit të fermerëve me specialistët për marrjen e informacionit lidhur me teknologjinë dhe tregjet. Nga të dhënat duket se interneti përdoret më shumë për aspekte të këshillimit mbi teknologjinë e prodhimit dhe marrjen e informacionit lidhur me inputet.

Të ardhurat nga ferma janë burimi kryesor i të ardhurave në Kurbin. Rreth 80% e fermerëve kanë të ardhura nga ferma, çka zë rreth 60% të të ardhurave të familjes. Pjesa më e madhe e prodhimit blegtoral (mbi 70%) dhe një pjesë e prodhimit bujqësor (nën 25%) janë të destinuar për treg. Si pasojë, të ardhurat nga blegtorja janë më të larta se ato nga bujqësia. Rreth 80% e fermerëve tregojnë që kanë të ardhura jashtë fermës të cilat zënë më pak se një e treta e të ardhurave vjetore në familje. Familjet e intervistuar në Kurbin deklarojnë se niveli i shpenzimeve është rreth 36,800 lekë të vjetra mesatarisht, i të ardhurave 41,807 lekë të vjetra mesatarisht. Rreth 12% të të ardhurave e kursajnë dhe vlera e kursimeve mesatare për familje (rreth 5000 lek) është më pak se një e dyta e vlerës së kursimeve në nivel zone projekti.

Duke qenë se vetëm rreth 20% e fermerëve u janë përgjigjur pyetjeve për mundësinë e të punuarit përgjatë periudhës kulmore të pandemisë, treguesit e ndikimit të pandemisë në funksionimin e fermës ka qenë i paqartë. Shumë pak të anketuar përmendin pamundësinë për të blerë mekanikë, farë apo plehra për mbjellje. Të intervistuarit që përmendin pandeminë si ndikuese në të ardhura janë ata që më së shumti janë prekur tek të ardhurat e tyre nga blegtoria dhe bujqësia (në Mamurras), të ardhurat nga jashtë fermës (Laç dhe Mamurras) dhe dërgesat nga emigracioni (në Mamurras). Transferte pagesat si pensione, ndihmë ekonomike apo asistencë papunësie e të tjera si këto nuk kanë pësuar ndryshime të ndjeshme.

Aftësitë vetëprodhuese të fermave janë të konsiderueshme, por variojnë sipas zonave. Në Mamurras (90% e fermave) dhe Laç (70% e fermave) një pjesë e madhe e fermave tregojnë mundësi të vetëprodhimit e më pak në Milot (41% e fermave) sidomos në vezë, produkte bulmeti e mish e më pak në fruta, perime e drithëra, kjo për shkak të sezonalitetit e mundësisë për të blerë.

Mesatarisht, familjet e anketuara në Kurbin e kanë patur disi të vështirë konsumin e produkteve të listuara (përgjatë muajve mars dhe prill). Për më tepër, 44% e të anketuarve deklarojnë se e kanë patur shumë të vështirë të konsumojnë makarona, oriz, sheqer apo vaj vegjetal përgjatë muajit mars-prill, produkte këto të cilat janë gjithashtu të tregtuara nga importi. Pamundësia e blerjes për këto produkte nis nga mungesat e përkohshme të levizjes dhe reduktime të përkohshme të sasisë së produkteve. Mungesa e qumështit dhe nënprodukteve të tij është shkaktuar tek familje të cilat nuk kanë patur vetë prodhim. Në renditje shfaqet edhe mishi, kryesisht për shkak të pamundësisë së thertoreve për tu furnizuar në ditët e para.

Në total, 66% e familjeve të anketuara në Kurbin kanë deklaruar se janë “pak të shqetësuar” nëse do të jenë në gjendje të sigurojnë për veten dhe familjen ushqim dhe artikujt bazë gjatë 2 muajve të ardhshëm (71% në Laç, 72% në Mamurras dhe 52% në Milot). Ndërsa vetëm 15% e familjeve në bashkinë Kurbin (të anketuara) kanë deklaruar se janë “shumë të shqetësuar” nëse do të jenë në gjendje të sigurojnë ushqim dhe artikujt bazë për familjen gjatë 2 muajve të ardhshëm (0% në Laç, 15% në Mamurras dhe 21% në Milot).

Më shumë se 50% e familjeve kanë deklaruar se në periudhën e pandemisë kanë patur raste ku janë shqetësuar në sigurimin e ushqimit për familjen, rreth 40% që kanë patur raste kur janë ushqyer me larmi të kufizuar e 27% që u është dashur ndonjëherë të konsumonin produkte që nuk preferojnë. Përpjesa e atyre që pohojnë shkallë më të larta të pasigurisë ushqimore, pra që kanë eksperiencë të vakteve të mpakura apo të ushqyerjes me vakte të munguara gjatë ditës është rreth 10%.

Mbi 65% e familjeve që deklarojnë një formë të pasigurisë së ushqimit, deklarojnë se këto shqetësime u shkaktuan nga pandemia, e çka është më e rëndësishme është së pjesa e atyre që pranojnë këtë pohim janë ata që vuajnë pasigurinë e lartë ushqimore, pra që kanë eksperiencë të mungesës së vakteve në ditë. Niveli i Pasigurisë (qasjes) Ushqimore ne Familje (HFIAS) është në zonë është i ulët pra me një vlerë mesatare 2, e cila është më e kënaqshme së mesatarja e zonës së projektit dhe shumë larg nga vlera maksimale (15 e cila tregon nivel ekstrem të pasigurisë ushqimore në familje). Analizat e korrelacionit tregojnë një lidhje të ngushtë e të rëndësishme nga ana statistikore midis HFIAS dhe sipërfaqes së tokës në dizpozicion për frymë.

Sipas analizës së treguesit të Prevalencës së Pasigurisë (qasjes) Ushqimore ne Familje (HFIAP), asnjë prej familjeve të anketuara në Kurbin nuk kanë një nivel të lartë të pasigurisë ushqimore (0% në secilën njësi administrative). Ndërsa 35% e familjeve kanë një nivel të konsiderueshëm të pasigurisë ushqimore (43% në Laç, 39% në Mamurras dhe 21% në Milot).

Rekomandime

Nisur nga gjetja se toka bujqësore e përdorur, hapësirat natyrore, ujrat dhe peizazhet janë tre burimet më të rëndësishme prodhuese në bashkinë Kurbin, projekti mund të konsiderojë një program rritjeje kapacitetesh për përdorimin e qëndrueshëm të këtyre burimeve. Aktivitete për t'u konsideruar mund të ishin, për shembull, praktika të mira të ruajtjes së shëndetit dhe funksionalitetit të tokës, manaxhimi i kullotave kolektive, manyrat e vjeljes së bimëve medicinale, veprimi kolektiv për manaxhimin e kullotave e pyjeve, etj. Sinergjia me ndërhyrje të cilat kryhen në parkun kombëtar do sillin më shumë efektivitet dhe burime financimi.

Të ardhurat nga blegtoria janë burimi kryesor i të ardhurave në Kurbin, e duke nisur nga faktorët e prodhimit duket se ato do vazhdojnë të jenë burim i tillë. Rreziku i reduktimit të numrit të krerëve, i rritjes së kontrollit në tregje dhe i alterimit të strukturës së prodhimit është akoma i largët. Projekti duhet të ndjekë mundësimin e fermerëve me ndërhyrje të cilat rrisin aksesin e produkteve drejt tregut, pa reduktuar diversifikimin e duke rritur vlerën për njësi. Mbështetja drejt produkteve shtazore duhet të priret drejt ndërhyrjeve në pajisje e mekanikë të lehtë, ofrimin e amballazheve dhe kontenierëve të qumështit dhe rritjen e kapaciteteve në prodhimin me higjenë e rendiment. Mbështetja drejt produkteve bimore duhet të drejtohet drejt prodhimit jashtë sezonit të bimëve të arave dhe frutave me vlerë të lartë. Duke marrë në konsideratë kufizimet e sipërfaqes së tokës, hapësirat e mundësueshme për fruta duhet të orientohen drejt frutave me vlerë të lartë e që shkojnë më së miri me mënyrat aktuale të konsumit. Përkrahje duhet ti jepet prodhimit që ngre vlerat e aktiviteteve të pritjes.

Për produktet e konsideruara me potenciale zhvillimi janë gjedhi, pemët frutore (pa arrorët), të imtat, prodhimi i perimeve dhe arrorëve, fokusi në rritjen e kapaciteteve duhet të vendoset në nevojat prioritare, duke përdorur kryesisht praktikën në terren dhe kombinimin e klasës me terrenin. Kurbin dallon qartësisht nga Maliqi në pikëpamje të metodës së trajnimit – në rastin e parë fermerët duket se kanë më shumë nevojë për njohuri teorike, në të dytin fermerët kanë më shumë nevojë për ndihmë dhe asistencë të personalizuar. Në Kurbin, ullinjët shekullorë nuk janë krasitur prej kohësh (ndoshta asnjëherë) për shkak të një mentaliteti se krasitja dëmton. Një vizitë e disa fermerëve të Kurbinin në Qendrën e Transferimit të Teknologjive në Vlorë për të parë rezultatet e krasitjes së rëndë të ullinjve mund të ishte shumë efikas në ndryshimin e mentalitetit të fermerëve.

Qasja për ofrimin e shërbimit të këshillimit mund të konsiderojë kombinimin e mbështetjes financiare në shkallë të vogël me shërbimin e këshillimit dhe rritjes së kapaciteteve sipas praktikave më të mira të testuara (Rasti i Kishës së Fushë-Kuqes). Përdorimi i infrastrukturës që ofrojnë donatorë të tjerë dhe ndërhyrjet me grante duhen bërë duke pritur propozime si nga individë apo grupe individësh. Shembull i mirë është marrja e ideve për sipëmarrje të lehta në zonën e Prespës, në kuadër të projekteve zhvillimore të Biosferës së Rezervatit të Prespës.

Nisur nga praktika e deritanishme e këshillimit, qasja dhe kapacitetet, ndërtimi i partneritetit me drejtorinë e bujqësisë dhe njësinë bashkiake duhet të konsiderohet me përparësi, krahas partneritetit klasik me tregtarët inputeve dhe blerësit e produkteve. Sipas shëmbujve të testuar në praktikë, projekti mund të konsiderojë bashkëpunimin edhe me institucione të tjera, përfshirë institucionet fetare, të cilat mund të kenë eksperiencë të vyera dhe mësim të mësuara nga sukseset por edhe dështimet.

Rekomandohet që fermerëve tu afrohet këshillim në “habitatin” e tyre, si një rrugë për rritjen e efektivitetit të aktiviteteve të rritjes së kapaciteteve. Krahas metodave tradicionale (të komunikimit fizik) të këshillimit dhe informimit, rekomandohet edhe eksplorimi i komunikimit virtual (përmes internetit) për rritjen e kapaciteteve. Kjo bëhet e mundur nisur nga fakti që fermerët aktualisht e përdorin internetin si mënyrë komunikimi.

Në zonat më larg atyre urbane projekti duhet gradualisht të ofrojë mundësi për rritjen e të ardhurave jashtë fermes. Rreth 80% e fermerëve tregojnë që kanë të ardhura jashtë fermës të cilat zënë më pak se një e treta e të ardhurave vjetore në familje. Personat me aftësi duhet të orientohen drejt mjeshtërive të kërkuara. Përzgjedhja e përonave duhet të kryhet duke marrë në konsideratë ngarkesat e detyrave familjare, aspektet gjinore dhe kushtëzime të tjera të fermës familjare.

Treguesit e ndikimit të pandemisë në funksionimin e fermës kanë qenë të paqartë për shkak të mungesës së përgjigjeve. Shumë pak të anketuar përmendin pamundësinë për të blerë mekanikë, farë apo plehra

për mbjellje. Duke marrë në konsideratë aftësitë vetëprodhuese dhe mangësitë që sjell mbyllja e qarkullimit të lëvizjes për shitjet informale (ecejaket drejt qytetit, levizja e automjeteve, etj.) nevoja për mbështetje për fermerët në rast të një faze të dytë të pandemisë do të ishte ofrimi i inpleteve të domosdoshme dhe rritja e mundësive të shitjes për produktet e ruajtura. Ndikimet e tjera janë në produktet e freskëta ku fermerët duhet të trajnohen në manipulimin dhe ruajtjen e tyre në rast të bllokimit të shitjes.

Konsumi në ferma është pjesërisht i mbështetur nga vetëprodhimi sidomos në vezë, produkte bulmeti e mish e më pak në fruta, perime e drithëra, kjo për shkak të sezonalitetit e mundësisë për të blerë. Në rast të një faze të zhvilluar të pandemisë, për të ulur kërcënimin e mundshëm të një pasigurie ushqimore, duhet të ofrohen paketa të përbëra nga makarona, oriz, sheqer apo vaj vegjetal si edhe farëra e fidanë për prodhimin e perimeve në rast se nuk është arritur ruajtja e farërave nga vetë familja. Pamundësia e blerjes për këto produkte duhet të bëhet duke selektuar familjet që shprehen me nivel më të lartë të pasigurisë ushqimore. Duke qenë se analiza tregon se këto familje janë ato me më pak tokë për frymë, atëherë WV duhet të nisë shpërndarjen e shënjestruar tek këto familje. Për të vlerësuar situatën, rekomandohet monitorim i vazhdueshëm i situatës së aksesit në ushqim në bashkërendim me matjen e performancës së aktivitetit bujqësor.

12. Referencat

Coates, J., Swindale, A., & Bilinsky, P. (2007). Household Food Insecurity Access Scale (HFIAS) for measurement of food access: indicator guide: version 3. E aksesueshme online në lidhjen: http://www.fao.org/fileadmin/user_upload/eufao-fsi4dm/doc-training/hfias.pdf

INSTAT (2020). Vjetari statistikor i Bujqësisë dhe i Blegtorisë 2019. Të aksesueshme online në lidhjen <http://instat.gov.al/al/temat/bujq%C3%ABsia-dhe-peshkimi/bujq%C3%ABsia/#tab2>

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (2017). Plani i përgjithshëm vendor i Bashkisë Dibër (2017). Strategjia territoriale dhe Plani i zhvillimit. I aksesueshëm online në lidhjen <http://planifikimi.gov.al/index.php?id=732>

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (2017). Plani i përgjithshëm vendor i Bashkisë Kurbin (2017). Strategjia territoriale dhe Plani i zhvillimit. I aksesueshëm online në lidhjen <http://planifikimi.gov.al/index.php?id=732>

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (2017). Plani i përgjithshëm vendor i Bashkisë Librazhd (2017). Strategjia territoriale dhe Plani i zhvillimit. I aksesueshëm online në lidhjen <http://planifikimi.gov.al/index.php?id=732>

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (2017). Plani i përgjithshëm vendor i Bashkisë Përrenjas (2017). Strategjia territoriale dhe Plani i zhvillimit. I aksesueshëm online në lidhjen <http://planifikimi.gov.al/index.php?id=732>

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (2020). Plani i përgjithshëm vendor i Bashkisë Maliq (2020). Strategjia territoriale dhe Plani i zhvillimit. I aksesueshëm online në lidhjen <http://planifikimi.gov.al/index.php?id=732>

Anekset

Tabela 42: Struktura moshore e popullsisë në Kurbin

	Kurbin							Total	
	Njësia Administrative								
	Laç	Mamurras	Milot						
deri në 4 vjeç	2	5.6%	19	5.3%	5	3.7%	26	4.9%	
5 deri 9 vjeç	1	2.8%	27	7.5%	4	3.0%	32	6.0%	
10 deri 14 vjeç	2	5.6%	19	5.3%	8	6.0%	29	5.5%	
15 deri 19 vjeç	5	13.9%	19	5.3%	15	11.2%	39	7.4%	
20 deri 24 vjeç	2	5.6%	31	8.6%	20	14.9%	53	10.0%	
25 deri 29 vjeç	4	11.1%	43	12.0%	10	7.5%	57	10.8%	
30 deri 34 vjeç	2	5.6%	20	5.6%	9	6.7%	31	5.9%	
35 deri 39 vjeç	2	5.6%	25	7.0%	6	4.5%	33	6.2%	
40 deri 44 vjeç	1	2.8%	14	3.9%	8	6.0%	23	4.3%	
55 deri 49 vjeç	4	11.1%	17	4.7%	7	5.2%	28	5.3%	
50 deri 54 vjeç	3	8.3%	28	7.8%	13	9.7%	44	8.3%	
55 deri 59 vjeç	1	2.8%	19	5.3%	14	10.4%	34	6.4%	
60 deri 64 vjeç	2	5.6%	31	8.6%	3	2.2%	36	6.8%	
65 deri 69 vjeç	0	0.0%	11	3.1%	9	6.7%	20	3.8%	
70 deri 74 vjeç	2	5.6%	11	3.1%	0	0.0%	13	2.5%	
75 deri 79 vjeç	2	5.6%	11	3.1%	2	1.5%	15	2.8%	
80 deri 84 vjeç	0	0.0%	5	1.4%	0	0.0%	5	0.9%	
mbi 85 vjeç	1	2.8%	9	2.5%	1	0.7%	11	2.1%	
Total	36	100.0%	359	100.0%	134	100.0%	529	100.0%	

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vrojtimit të strukturuar


Tabela 43: Perceptimet e fermerëve mbi aktivitetin e dytë dhe të tretë potencial

Aktivitetet ekonomike	Prioriteti i dytë			
	Kurbin		Zona e projektit	
	Numër	%	Numër	%
Prodhimi i arreveve	19	17.9%	39	8.9%
Gjedhi	18	17.0%	102	23.2%
Prodhimi i perimeve	17	16.0%	54	12.3%
Prodhimi i frutave (pa aroret)	12	11.3%	53	12.1%
Përpunim qumështi në fermë	8	7.5%	14	3.2%
Bletaria	7	6.6%	33	7.5%
Të imtat	7	6.6%	68	15.5%
Përpunim fruta-perime në fermë	6	5.7%	13	3.0%
Derri	3	2.8%	6	1.4%
Akuakultura	3	2.8%	6	1.4%
Tjetër	6	6%	51	12%
Total	106	100%	439	100%
Prioriteti i tretë				
Prodhimi i perimeve	21	19.8%	48	10.9%
Prodhimi i frutave (pa aroret)	16	15.1%	70	15.9%
Prodhimi i arreveve	12	11.3%	34	7.7%
Bletaria	10	9.4%	71	16.2%
Përpunim fruta-perime në fermë	9	8.5%	27	6.2%
Përpunim qumështi në fermë	8	7.5%	17	3.9%
Turizmi në fermë	6	5.7%	32	7.3%
Gjedhi	5	4.7%	24	5.5%

Derri	5	4.7%	11	2.5%
Të imtat	5	4.7%	27	6.2%
Tjetër	9	8%	78	18%
Total	106	100%	439	100%

Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vërtetimit të strukturuar

Figura 24: Nevoja e pare prioritare për rritje kapacitetesh per produktin e dyte prioritari



Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e vërtetimit të strukturuar

Tabela 44: Sipërfaqja e bimëve të arave sipas bashkive 2019

Nr	Bashkia	Drithëra	Grurë	Misër	Theker	Perime	Patate	Fasule	Foragjere	BAM
1	Dibër	3,661	520	3,000	50	550	288	138	10,550	8
2	Librazhd	1,990	575	1,288	65	266	274	340	2,549	5
3	Prrenjas	1,683	670	963	26	172	142	224	1,661	7
4	Maliq	6,790	4,426	1,648	87	1,220	1,010	524	4,469	49
5	Kurbin	1,539	690	829	-	615	112	190	5,210	14

Burimi: INSTAT (2020)

Tabela 45: Prodhimi i bimëve të arave sipas bashkive 2019

Nr	Bashkia	Drithëra	Grurë	Misër	Theker	Elb	Tagjira	Perime	Patate	Fasule	Foragjere	BAM
1	Dibër	22,291	2,010	19,976	100	108	97	14,612	8,478	1,517	226,651	5
2	Librazhd	9,434	2,270	6,874	163	-	127	5,824	6,439	660	84,080	9
3	Prrenjas	7,649	2,664	4,867	65	-	53	3,751	3,341	414	56,474	14
4	Maliq	31,037	19,246	9,689	222	1,256	624	36,858	31,014	819	136,743	78
5	Kurbin	9,380	2,760	6,558	-	-	62	17,046	3,584	357	209,775	126

Burimi: INSTAT (2020)

Tabela 46: Prodhimi i perimeve sipas bashkive 2019

Nr	Qarku	Perime të Njoma	Perime të Thata	Bostanore	Perime Gjithsej
1	Dibër	10,979	2,439	1,194	14,612
2	Librazhd	4,731	812	282	5,824
3	Prrenjas	3,036	570	145	3,751
4	Maliq	9,702	26,159	997	36,858

5	Kurbin	11,809	982	4,255	17,046
---	--------	--------	-----	-------	--------

Burimi: INSTAT, 2020

Tabela 47: Gjendja numerike e drufrutorëve, 2019

Nr	Bashkia	Pemë frutore	Ullinj	Agrume	Vreshti (Ha)	Pjergulla
1	Dibër	880	-	-	64	143
2	Librazhd	187	4	-	43	100
3	Prrenjas	137	-	-	86	68
4	Maliq	718	-	-	168	82
5	Kurbin	198	115	18	139	197

Burimi: INSTAT (2020)

Tabela 48: Prodhimi i drufrutorëve, 2019 në Ton

Nr	Bashkia	Peme frutore	Rrush nga vreshti	Rrush nga pjergulla	Rrush gjithsej
1	Dibër	15,870	680	1,600	2,280
2	Librazhd	4,296	418	1,423	1,841
3	Prrenjas	3,412	857	985	1,842
4	Maliq	12,548	861	1,376	2,237
5	Kurbin	4,026	2,223	1,686	3,909

Burimi: INSTAT (2020)

Tabela 49: Numri i krerëve të blegtorisë sipas bashkive, 2019

Nr.	Bashkia	Gjedhë	Lopë	Të imta	Të leshta	Dele	Të dhirta	Dhi	Derra	Shpendë	Koshere bletë
1	Dibër	15,000	11,000	92,000	63,000	52,000	29,000	25,000	100	130,000	13,000
2	Kurbin	11,175	7,760	19,550	5,760	4,210	13,790	10,350	12,270	90,050	1,816
3	Librazhd	7,250	5,800	38,800	22,500	16,700	16,300	13,000	480	93,720	2,600
4	Maliq	9,999	8,032	93,221	74,120	60,478	19,101	15,443	2,339	103,691	8,498
5	Prrenjas	3,750	2,700	27,300	16,900	11,000	10,400	7,500	-	60,830	1,800

Burimi: INSTAT (2020)

Tabela 50: Prodhimi i qumështit, 2019 (Ton)

Nr.	Bashkia	Lopë	Dele	Dhi
1	Dibër	28,600	2,912	2,675
2	Kurbin	18,702	261	1,335
3	Librazhd	21,156	1,188	2,310
4	Maliq	36,144	3,629	1,699
5	Prrenjas	9,461	816	1,336

Burimi: INSTAT (2020)

Tabela 51. Prodhimi i mishit - peshë e gjallë, 2019 (ton)

Nr.	Bashkia	Gjithsej	Gjedhë	Të leshta	Të dhirta	Derri	Shpendë
1	Dibër	4,351	2,185	1,456	500	10	200
2	Kurbin	2,260	566	89	152	1,316	137
3	Librazhd	2,649	1,519	600	376	22	131
4	Maliq	3,861	1,804	1,378	369	207	103
5	Prrenjas	1,414	694	394	240	-	85

Burimi: INSTAT (2020)